UDHËZUES PËR ADRESIMIN E PLASTIKËS NJËPËRDORIMËSHE NËPËRMJET PROKURIMIT PUBLIK NË MESDHE

UN environment
United Nations Environment Programme

Mediterranean Action Plan
Barcelona Convention

Regional Activity Centre for Sustainable Consumption and Production

MINISTERO DELL'AMBIENTE
E DELLA TUTELA DEL TERRITORIO E DEL MARE

Rreth

Ky botim është mandatuar nga QRA/KPQ drejt Ecoinstitut, si pjesë e portofolit të aktiviteteve për të përmirësuar kuadrin e politikave dhe për t'u angazhuar me industrinë e ushqimit dhe pijeve në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, përmes Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet KB për Mjedisin/PVM dhe Ministrisë Italiane të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit.

QRA/KPQ ka një mandat zyrtar nga Palët Kontraktuese në Konventën e Barcelona për tu angazhuar në bashkëpunim ndërkombëtar me vendet e Mesdheut për parandalimin e ndotjes nga plastika, përfshirë mbetjet detare dhe në zhvillimin dhe inovacionin në sektorin e biznesit.

Ecoinstitut S.C.C.L. është një kooperativë pune jo-fitimprurëse e përbërë nga profesionistë me sfond të larmishëm akademik dhe profesional. Ka përvojë të gjerë në politikat publike dhe çështjet e qëndrueshmërisë, veçanërisht në prokurimin e gjelbër dhe të qëndrueshëm publik.

Dizajni dhe ilustrimet: Estudio Discursiva

Imazhe: Pixabay dhe The Switchers

Dhjetor 2019

COPYRIGHT/AUTORËSIA Ky botim mund të riprodhohet, plotësisht ose pjesërisht, për qëllime edukative ose jofitimprurëse pa lejen specifike të QRA/KPQ me kusht që të përmendet burimi. QRA/ KPQ do të dëshironte të merrte një kopje të çdo botimi i cili ka marrë këtë material si referencë. Ky publikim nuk mund të shitet ose përdoret për ndonjë qëllim tjetër tregtar pa autorizim të shkruar nga QRA/ KPQ.

MOHIM/DISCLAMER Ky botim u mundësua si pjesë e aktiviteteve të QRA/ KPQ në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet KB për Mjedisin/PVM dhe Ministrisë Italiane të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit. Për çdo detaj në përpilimin e këtij raporti është kujdesur QRA/ KPQ, ndërsa as QRA/ KPQ dhe as KB për Mjedisin / PVM dhe Ministria Italiane e Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për çfarëdo humbje që mund t'i shkaktohet një personi (duke përfshirë por pa u kufizuar në humbje të drejtpërdrejta, të tërthorta, apo humbje të fitimit, të të dhënave ose humbje ekonomike), apo dëmtim, kosto, pretendim ose shpenzim që shkaktohet duke u mbështetur në këtë raport ose nga përmbajtja e tij (përveç se nëse kjo parashikohet në ligj).

Parathënie

Takimi i Tetëmbëdhjetë i Zakonshëm i Palëve Kontraktuese në Konventën për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut ("Konventa e Barcelonës"), e mbajtur në Stamboll, Turqi, nga data 3 deri në 6 Dhjetor 2013, miratoi Vendimin IG. 21/7 që lidhet me Planin Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve Detare në Mesdhe referuar Nenit 15 të Protokollit për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja nga Burimet dhe Aktivitetet e Vendosura në Tokë (Protokolli BAVT) të Konventës së Barcelonës, në vijim referuar si Plani Rajonal i Mbetjeve Detare (KB për Mjedisin (DEPI) / PVM IG.21 / 9).

Për më tepër, dhe në përputhje me Nenin 14 të Planit Rajonal të Mbetjeve Detare, Sekretariati në bashkëpunim me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale, është i detyruar të përgatisë udhëzime specifike duke marrë parasysh kur është e nevojshme udhëzimet ekzistuese, për të mbështetur dhe lehtësuar zbatimin e masave të parashikuara në Nenet 9 dhe 10 të tyre, me anë të të cilave, në varësi të disponueshmërisë së fondeve të jashtme, udhëzime të tilla do të publikohen në gjuhë të ndryshme të rajonit të Mesdheut.

Programi i Punës PVM (PP) 2018-2019 i miratuar nga Takimi i Njëzetë i Zakonshëm i Palëve Kontraktuese në Konventën e Barcelonës dhe Protokollet e tij, të mbajtur në Tiranë, Shqipëri, nga data 17 deri në 20 dhjetor 2017, përmban disa aktivitete që adresojnë mbetjet detare përfshirë implementimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet KB për Mjedisin / PVM dhe Ministrisë Italiane të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit, e cila ka rezultate specifike në zhvillimin e një sërë udhëzimesh teknike referuar nenit 14 të Planit Rajonal.

Prokurimi publik ndikon në një pjesë të konsiderueshme të tregtisë botërore, duke arritur mesatarisht 10-25% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendit ose PBB-së, për këtë arsye prokurimi publik luan një rol kryesor në arritjen e modeleve më të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit. Nëpërmjet efektit të saj tërheqës, prokurimi publik mund të nxisë ndryshime në zinxhirin e furnizimit me një efekt pozitiv në pjesën tjetër të tregut; dhe në të njëjtën kohë, të kryej funksionin në mënyrë të përgjegjshme. Mbetjet detare janë një nga problemet mjedisore të Mesdheut dhe, si me prioritetet e tjera mjedisore, prokurimi publik mund të kontribuojë në trajtimin e tyre, kjo është arsyeja pse veprimet e prokurimit publik janë pjesë e shumë politikave dhe strategjive që adresojnë mbetjet detare - ashtu si Plani Rajonal për Menaxhimi e Mbetjeve Detare në Mesdhe, Plani Rajonal i Veprimit për Konsum dhe Prodhim të Qëndrueshëm në Mesdhe. Roli i prokurimit publik për të trajtuar ndotjen e paketimeve plastike është njohur gjithashtu nga Kuadri 10-vjeçar i Programeve për Konsum dhe Prodhim të Qëndrueshëm të miratuar në Samitin Botëror të Zhvillimit të Qëndrueshëm Rio +20 i cili ka filluar një iniciativë për të adresuar paketimin plastik përmes tregut- duke mundësuar fushat e stilit të jetesës, arsimit, informacionit të konsumatorit dhe prokurimit publik.

Udhëzimet synojnë të sigurojnë një kuptim të përbashkët të grupit të masave dhe kritereve mjedisore që mund të merren parasysh në zhvillimin e një kuadri më të përshtatshëm ligjor dhe operacional për të adresuar plastikën njëpërdorimëshe në prokurimet publike në vendet nënshkruese të Konventës së Barcelonës. Ndërsa këto udhëzime përqendrohen në procesin

e marrjes së vendimeve, nga mungesa e veprimeve deri në një program gjithëpërfshirës të konsiderimit të plastikës njëpërdorimëshe në prokurimin publik, ato gjithashtu mund të përdoren për të plotësuar dhe forcuar veprimet në vendet ku procesi është në vazhdim. Udhëzimet bazohen në rishikimin dhe mësimet e marra nga çështjet ndërkombëtare, duke marrë parasysh kontekstin në rajonin e Mesdheut dhe veprimet specifike të mbështetura nga komponentët e KB për Mjedisin / Plani i Veprimit Mesdhetar (PVM) në disa nga vendet.

Këto udhëzime prezantojnë subjektin duke shpjeguar qëllimin e udhëzimeve dhe pse prokurimi publik mund të kontribuojë në uljen e krizës së plastikës. Në vazhdim, dokumenti përshkruan në mënyrë gjithëpërfshirëse një hartë të zbatimit të 10 hapave, përfshirë disa shembuj. Në fund, Shtojca I ofron një model të politikës për të kufizuar blerjen dhe përdorimin e plastikës njëpërdorimëshe; Shtojca II përpilon kritere të ndryshme që do të futen në prokurimin publik për secilin nga sektorët kryesorë të udhëzimeve; Shtojca III paraqet shembuj të ndryshëm për të ilustruar një larmi hapash dhe veprimesh të mundshme; dhe Shtojca IV jep përkufizime për disa nga termat e përdorur në udhëzime.

Ky dokument është zhvilluar në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet KB për Mjedisin/PVM dhe Ministrisë Italiane të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit. QRA/KPQ ja ka mandatuar këtë punë Ecoinsitut, e cila është një kooperativë pune jo-fitimprurëse, e përbërë nga profesionistë me sfond të larmishëm akademik dhe profesional. Ka përvojë të gjerë në politikat publike dhe çështjet e qëndrueshmërisë, veçanërisht në prokurimin e gjelbër dhe të qëndrueshëm publik.

Tabela e përmbajtjes

04	1. Hyrje
04	1.1. Qëllimi
05	1.2. Problematika
08	2. Rruga për të shmangur plastikën njëpërdorimëshe përmes prokurimit publik
09	2.1. Masat paraprake (hapi 1, 2, 3 dhe 4)
12	2.2. Miratimi dhe implementimi i opsioneve specifike të prokurimit publik (hapat 5, 6 and 7)
13	2.3. Masa shoqëruese (hapat 8, 9 dhe 10)
15	Shtojca
15	Shtojca I. Një model tip për instrumentin rregullator: Politika për të kufizuar blerjen dhe përdorimin e plastikës njëpërdorimëshe
19	Shtojca II. Përpilimi i kritereve të mundshme për tu përfshirë në proçeset e prokurimit
24	Shtojca III. Përpilimi i shembujve nga autoritetet publike
32	Shtojca IV. Terminologjia

Udhëzues për Adresimin e Plastikës Njëpërdorimëshe Nëpërmjet Prokurimit Publik në Mesdhe

1. Hyrje

1.1. Qëllimi

Plastika dhe veçanërisht plastika njëpërdorimëshe, përfaqësojnë 95% të mbetjeve detare të grumbulluara në Detin Mesdhe dhe brigjet e tij[1]. Nga analiza e mbetjeve detare të gjetura në plazhe rezulton se ato janë kryesisht artikuj dhe paketimet plastike njëpërdorimëshe nga sektori i ushqimit dhe pijeve si (tabaka, pipëza, gota, thika, lugë, pirunj dhe shishe plastike) dhe qese plastike[2,3]. Depozitimi e tyre në mjedis ka ndikime të dëmshme jo vetëm në mjedis, por edhe në zhvillimin ekonomik dhe shëndetin publik; dhe rreziku mund të rritet duke pasur parasysh trendin drejt një rritje të konsiderueshme në gjenerimin e mbetjeve plastike, nga të cilat një pjesë shumë e madhe vjen nga paketimet e përdorura në sektorin e ushqimit dhe pijeve[4].

Plani Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve Detare në Mesdhe[5], i miratuar në vitin 2013 nga Palët Kontraktuese të Konventës së Barcelonës, nxit qeveritë të miratojnë politika për zvogëlimin e mbetjeve plastike, të mbështesë industrinë për të minimizuar paketimin plastik dhe të ri-dizajnojnë produktet e tyre si dhe të ndryshojnë zakonet e konsumatorit. Plani, si dhe në politikat e tjera të rëndësishme për rajonin, siç është Plani Rajonal i Veprimit për Konsum dhe Prodhim të Qëndrueshëm në Mesdhe[6] ose Strategjia Evropiane për Plastikë në një Ekonomi Qarkulluese[7], njohin prokurimin publik si një instrument që mund të kontribuojë në trajtimin e problemit për shkak të natyrës së tij tërthore - është shprehja e sektorit publik si konsumator, është një instrument tregu që inkurajon industritë të përmirësojnë praktikat e tyre dhe ai kontribuon në arritjen e objektivave të reduktimit të plastikës.

Këto udhëzime synojnë të ofrojnë një kuptim të përbashkët të masave të cilat mund të merren parasysh në hartimin e politikave më të përshtatshme ose një kornize rregullatore për të adresuar problematikën me plastikën njëpërdorimëshe përmes prokurimit publik, bazuar në përvojat e autoriteteve të shumta publike. Rekomandimet përqendrohen në dy kategori në përputhje me sektorët prioritare të Bashkimit Evropian për ekonominë qarkulluese[8] dhe fushat prioritare për të shmangur mbetjet detare:

- Plastika njëpërdorimëshe në sektorin e ushqimit dhe pijeve, e cila nga këndvështrimi i prokurimit publik ka të bëjë me blerjet dhe kontratat për ofrimin e shërbimeve ushqimore në institucionet publike (shkolla, spitale, universitete ...); shërbimet e kateringut nëpër takime, konferenca dhe evente; dhe shërbime shitjeje nëpërmjet makinerive të automatizuara; dhe
- Paketimi në përgjithësi, i aplikuar për çdo punë dhe shërbim të kryer nga autoritetet publike.

Këto udhëzime synojnë hartuesit e politikave në vendet nënshkruese të Konventës së Barcelonës dhe u sigurojnë atyre një qasje, hap pas hapi, për zhvillimin

1. UNEP / MAP (2015). Vlerësimi i Mbetjet Detare në Mesdhe 2015. Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin / Plani i Veprimit në Mesdhe. http://web.unep.org/unepmap/marine-litter-assessment-mediterranean-2015

2. Hanke G. (2016). Marine Beach Litter in Europe – Top Items. Technical Report by the Joint Research Centre. https://mcc.jrc.ec.europa.eu/documents/Marine_Litter/MarineLitterTOPitems_final_24.1.2017.pdf

3. UNEP/MAP (2019) Vlerësimi i Mbetjeve Detare: Azhornimi i Vlerave Fillestare dhe Vlerat e Pragut për IMAP Indikatorët e Mbetjeve Detare. UNEP/MED ËG.476/3.

4. Komisioni Evropian (2018). Një Strategji për Plastikën në një Ekonomi Qarkulluese. https://ec.europa.eu/environment/circular-economy/pdf/plastics-strategy-brochure.pdf

5. UNEP/MAP (2013). Plani Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve Detare në Mesdhe. https://wedocs.unep.org/rest/bitstreams/8222/retrieve

6. UNEP / MAP (2017). Plani rajonal i veprimit për konsum dhe prodhimin të qëndrueshëm në Mesdhe. Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin / Plani i Veprimit për Mesdheun.

7. Komisioni Evropian, Një Strategji Evropiane për Plastikën.

8. Komisioni Evropian (2019). Produkte të Qëndrueshme në një Ekonomi Qarkulluese - Drejt një Kuadri të Politikave për Produkte të BE-së që kontribuojnë në Ekonominë Qarkulluese. https://ec.europa.eu/environment/circular-economy/pdf/sustainable_products_circular_economy.pdf, Strategjia Evropiane për Plastikat e lartpërmendur, në një Ekonomi Qarkulluese ose në Direktivën (BE) 2019/904 për uljen e ndikimit të produkteve të caktuara plastike në mjedis. https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2019/904/oj

e kornizës së duhur për të kufizuar prokurimin dhe përdorimin e plastikës njëpërdorimëshe në sektorin publik.

Ato përfshijnë procesin e plotë të marrjes së vendimeve, nga mungesa e veprimeve deri në një program gjithëpërfshirës për të adresuar plastikën njëpërdorimëshe përmes prokurimit publik, kështu që ato mund të përdoren për të plotësuar dhe forcuar veprimet në vendet që tashmë janë duke zbatuar kriteret mjedisore në proceset e tyre të prokurimit.

Përpunimi është porositur nga QRA/KPQ tek Ecoinstitut, si pjesë e portofolit të aktiviteteve për të përmirësuar kornizën e politikave dhe për t'u angazhuar me industrinë e ushqimit dhe pijeve në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, përmes Marrëveshjes së Bashkëpunimit të KB për Mjedisin / PVM (Plan i Veprimit në Detin Mesdhe) dhe Ministrisë Italiane të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Detit. Pë këtë arsye, situata në këto vende është marrë në konsideratë veçanërisht për përpunimin e dokumentit, përveç studimeve të tjera të rasteve në Mesdhe dhe më gjerë. Si rezultat, udhëzimet janë funksionale në nivelin rajonal.

Siç u përmend më parë, prokurimi i gjelbër publik është një mjet i shkëlqyeshëm për të nxitur ekonominë qarkulluese dhe në fund zvogëlimin e mbetjeve plastike detare. Kështu, udhëzimet do të promovohen gjerësisht përmes sistemit të Konventës së Barcelonës.

1.2. Problematika

Plastika është kthyer në një material thelbësor dhe i përhapur në ekonominë tonë dhe jetën e përditshme për shkak të vetive të saj funksionale dhe kostos së ulët. Përdorimi i saj është rritur në mënyrë eksponenciale që nga vitet 1960, dhe pritet të dyfishohet gjatë 20 viteve të ardhshme[9].

Në rang Global, paketimi plastik është forma më e shpeshtë e aplikimit të plastikës, që përfaqëson 26% të vëllimit të përgjithshëm të plastikës së përdorur. Si material paketimi, plastika është veçanërisht e lirë, me peshë të lehtë dhe me performancë të lartë dhe për pasojë plastika po zëvendëson gjithnjë e më shumë materialet e tjera të paketimit. Në vitin 2013, 78 milion ton paketim plastik u prodhuan në të gjithë botën dhe volumet e paketimeve plastike pritet të vazhdojnë rritjen e tyre të fortë duke e dyfishuar volumin e tyre brenda 15 viteve dhe katërfishuar atë deri në vitin 2050. Problemi, sidoqoftë është se përafërsisht 95% e vlerës së materialit të paketimit plastik humbet në ekonomi pas një përdorimi të shkurtër fillestar – 72% e paketimit plastik nuk rikuperohet për shkak se depozitohet në lendfill (40%) ose depozitohet në mjedis në mënyrë të pakontrolluar (32%), 14% humbet pas djegies në incenerator dhe madje edhe kur grumbullohet për riciklim një pjesë humbet gjatë procesit dhe një pjesë riciklohen në produkte me vlerë të ulët të cilat nuk mund të riciklohen pas fazës së përdorimit[10].

Ky lloj informacioni nuk është i disponueshëm në rang Mesdheu akoma. Sidoqoftë, disa studime si ai i porositur nga QRA/KPQ[11] në nivelin nën-rajonal (Shqipëria, Bosnje Hercegovina dhe Mali i Zi) japin informacione interesante. Këto vende grumbullojnë mesatarisht 78% të paketimeve plastike të ardhura nga sektori i ushqimit dhe pijeve, që do të thotë se 22% i mbetur depozitohet në vend grumbullime të pakontrolluara ose depozitohet në mënyrë të pakontrolluar në mjedis. Nga materialet e grumbulluara vetëm 3.2% e tyre shkojnë për riciklim. Në rastin e BE, nga 27 milion ton mbetje plastike të gjeneruara çdo vit vetëm një e treta riciklohet; vetëm gjysma e të gjithë mbetjeve plastike të gjeneruara në Itali, Francë dhe Spanjë përfundon në lendfill[12].

Deti Mesdhe dhe brigjet e tij janë kthyer në një nga zonat më të prekura nga mbetjet detare në botë[13]. Plastika është tipologjia mbizotëruese e cila përbën 95% deri në 100% të mbetjeve pluskuese dhe më shumë se 50% të fundit të tij. Analiza 33 plazheve e cila është kryer në vitin 2016[14] tregon se vetëm 5 lloje mbetjesh, kryesisht plastikë njëpërdorimëshe (pipëza, tabaka, servise të tavolinës, filtra cigaresh, shishe plastike dhe qeset plastike) përfaqësojnë më shumë se 60% të mbetjeve totale të regjistruara në plazhe.

Mbetjet detare janë një kërcënim global në rritje për shkak të implikimeve të rëndësishme mjedisore, sociale, ekonomike, politike dhe kulturore. Ndikimet kryesore në organizmat detarë janë të lidhura me ngatërrimin këtyre gjallesave në materiale të makro-plastikës (rrjetat e peshkimit) dhe gëlltitjen e mikro-plastikës. Megjithatë, ka dëshmi gjithnjë e në rritje se grimcat

9. Komisioni Evropian, Një Strategji Evropiane për Plastikën.

10. Fondacioni Ellen MacArthur dhe SCP / RAC (2017). Ekonomia e Re e Plastikës - Rishikimi i së ardhmes së plastikës dhe veprimit katalizues. https://www.ellenmacarthurfoundation.org/publications/the-new-plastics-economy-rethinking-the-future-of-plastics-catalysing-action

11. SCP/RAC (2019). Fushat prioritare të ndërhyrjes për të eliminuar mbetjet plastike nga sektori i ushqimit dhe pijeve në Shqipëri, Bosnje Hercegovinë dhe Mal të Zi http://www.cprac.org/docs2/91216_priority_areas_alb_0.pdf

12. Alessi, E. et al. (2018). Jashtë grackës plastike: shpëtoni Mesdheun nga ndotja prej plastikës. Iniciativa Detare për Mesdheun WWF https://d2ouvy59p0dg6k.cloudfront.net/downloads/a4_plastics_med_web_08june_new.pdf

13. UNEP/MAP (2017). 2017 Mediterranean Quality Status Report. https://www.medqsr.org/sites/default/files/inline-files/2017MedQSR_Online_0.pdf

14. Hanke G. (2016). Mbetjet Detare në Evropë – Artikujt Kryesorë. Raporti Teknik nga Qendra e Përbashkët e Kërkimit (QPK). https://mcc.jrc.ec.europa.eu/documents/Marine_Litter/MarineLitterTOPitems_final_24.1.2017.pdf



Burimi: Plastikë njëpërdorimëshe

Një udhërrëfyes drejt qëndrueshmërisë – OKB për Mjedisin/UNEP

plastike mund të mbajnë dhe transferojnë substanca toksike (ndotës organikë të vazhdueshëm dhe kimikate që prishin gjëndrat endokrine) në organizmat detarë, kryesisht kur gëlltiten, që gjithashtu mund të rrezikojnë shëndetin e njeriut përmes zinxhirëve ushqimorë[15]. Por mbetjet detare mund të kenë gjithashtu pasoja sociale dhe ekonomike siç janë ndikimi në mirëqenie, rritjen e kostove, si kostoja e pastrimit të brigjeve detare ndër të tjera.

Për të shmangur plastikën njëpërdorimëshe, veprimet duhet të jenë në përputhje me parimet e ekonomisë qarkulluese dhe të zbatojnë të njëjtat përparësi si në hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve, të përcaktuar në Planin Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve Detare në Mesdhe (Vendimi IG. 21/7), i cili në nenin 9 (1) parashikon aplikimin e tij duke ndjekur hierarkinë e mbetjeve si rend prioritar në legjislacionin dhe politikat për parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve: parandalim, përgatitje për ripërdorim, riciklim, rikuperime të tjera p.sh. rikuperim energjie dhe depozitimi përfundimtar, për të parë alternativat (shih Figurën 1). Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ato vende mesdhetare ku grumbullimi dhe menaxhimi i mbetjeve është i organizuar dobët, duke e bërë parandalimin dhe ripërdorimin edhe më të rëndësishëm. Sidoqoftë, kujdesi i duhur duhet të ushtrohet gjithnjë dhe shëndeti, siguria, mjedisi dhe aksesi të merren në konsideratë kur zgjidhen alternativa për sendet plastike njëpërdorimëshe.

Për të trajtuar këtë çështje, kërkohen ndryshime në të dy anët e tregut - ana e prodhimit dhe e konsumit. Organizatat publike funksionojnë si rregullatorë të tregut, por edhe si pjesëmarrës në treg, d.m.th. si konsumatorë, përmes kontratave dhe blerjeve të tyre[16].

15. Fondacioni Ellen MacArthur dhe SCP / RAC. Ekonomia e Re e Plastikës.

16. McCrudden, C. në Adell, A. dhe Schaefer. B. (2019). Promovimi i Ekonomisë Qarkulluese përmes Prokurimit Publik [Publikim]. Procedurat e Konferencës së ERSCP, Barcelonë 13-18 Tetor 2019.

17. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore (2017). Të Bësh Biznes 2017. Mundësi të Barabarta për të Gjithë. Grupi I Bankës Botërore. https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/media/Annual-Reports/English/DB17-Report.pdf

18. Adell, A. dhe Schaefer. B., Promovimi i Ekonomisë Qarkulluese përmes Prokurimit Publik [Publikim].

Prokurimi publik ndikon në një pjesë të konsiderueshme të tregtisë botërore, duke arritur mesatarisht në 10 deri në 25% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendit ose PBB-së[17], për këtë arsye prokurimi publik luan një rol kryesor në arritjen e modeleve më të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit. Megjithë efektin e saj tërheqës, prokurimi publik mund të nxisë ndryshime në zinxhirin e furnizimit me një efekt pozitiv në pjesën tjetër të tregut; dhe në të njëjtën kohë dhe të drejtojë funksionin e sajë në mënyrë të përgjegjshme.

Për gati pesëdhjetë vjet, qeveria në të gjitha nivelet ka prezantuar kritere mjedisore në blerjet e saj. Një nga politikat e para, përfshirë detyrimet e PGjP-së, ishte Akti i vitit 1976 i Konservimit dhe Riparimit të Burimeve e Qeverisë së SHBA, i cili u kërkonte agjencive federale të "prokuronin sende të përbëra me përqindje më të lartë të materialeve të rikuperueshme aty ku mund të praktikohej"[18]. Që atëherë, shumë politika të tjera janë zbatuar për të zvogëluar ndotjen, për të promovuar produktet e gjelbërta, për të luftuar ndryshimin e klimës ose për të mbrojtur pyjet përmes prokurimit publik.

Mbetjet detare janë një nga problemet mjedisore të Mesdhut dhe, si me prioritetet e tjera mjedisore, prokurimi publik mund të kontribuojë në trajtimin e tyre, kjo është arsyeja pse veprimet e prokurimit publik janë pjesë e shumë politikave dhe strategjive që adresojnë mbetjet detare - ashtu si Plani Rajonal për Menaxhimin e Mbetjeve Detare në Mesdhe, Plani Rajonal i Veprimit për Konsum dhe Prodhim të Qëndrueshëm në Mesdhe ose Strategjia Evropiane për Plastikë në një Ekonomi Qarkulluese të përmendur më parë. Roli i prokurimit publik për të shmangur ndotjen e paketimeve plastike është njohur gjithashtu nga Korniza 10-vjeçare e Programeve për Konsum dhe Prodhim e Qëndrueshëm të miratuar në Samitin Botëror të Zhvillimit të Qëndrueshëm Rio +20 i cili ka filluar një iniciativë për të adresuar paketimin plastik përmes tregut- duke e aplikuar në fushat edukimit, informacionit të konsumatorit dhe prokurimit publik.

Kjo është arsyeja pse QRA/KPQ ka prodhuar këto udhëzime, për të ndihmuar qeveritë të përcaktojnë politika dhe veprime për të kontribuar në luftimin e mbetjeve detare përmes prokurimit publik.

18. Adell, A. dhe Schaefer. B., Promovimi i Ekonomisë Qarkulluese përmes Prokurimit Publik [Publikim].

2. Rruga për të shmangur plastikën njëpërdorimëshe përmes prokurimit publik

Duke marrë parasysh përvojat në rajonin e Mesdheut dhe më gjerë, zgjidhjet e shëndosha duhet të hartohen në një hark kohor afatmesëm. Një qasje progresive, hap pas hapi duhet të përdoret për të siguruar që:

a) Burimet qeveritare, udhëzimet dhe mekanizmat e monitorimit janë krijuar për të përdorur me sukses prokurimin publik për të zvogëluar blerjen dhe përdorimin e plastikës njëpërdorimëshe dhe për të rishikuar dhe përshtatur qasjet nëse nuk përmbushen objektivat.

b) Industria përkatëse ka kohë / stimuj / akses në teknologji për t'i lejuar ata të prodhojnë dhe ofrojnë alternativa të shëndosha nga ana ekonomike / mjedisore / teknike, pa pasur humbje të vendeve të punës / të ardhurave.

c) Standardet dhe normat përkatëse janë vendosur për të siguruar prodhimin e alternativave më të sigurta dhe për të ndihmuar në përcaktimin dhe verifikimin e specifikimeve të tenderit.

d) Kompanitë janë të vetëdijshme për ndikimet e alternativave të ndryshme dhe janë të incentivuar për të modifikuar praktikat e tyre të prodhimit dhe shërbimeve; dhe përdoruesit janë gjithashtu të vetëdijshëm për ndikimin e sjelljes së tyre dhe janë të motivuar të modifikojnë mënyrën e tyre të konsumit.

e) Sistemi i menaxhimit të mbetjeve në këto vende është përshtatur për të zbatuar masa shtesë për të zvogëluar ndikimet e plastikës njëpërdorimëshe. Së pari, është e rëndësishme që grumbullimi i diferencuar dhe riciklimi të përmirësohen dhe të shmanget depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve. Më vonë, sistemi i menaxhimit të mbetjeve mund të duhet të përshtatet me alternativat e reja të prezantuara/hedhura në treg, siç janë artikujt e kompostueshëm.

Procesi për të trajtuar plastikën njëpërdorimëshe përmes prokurimit publik përbëhet nga 10 hapat e listuar më poshtë. Vendet që tashmë po zbatojnë kriteret mjedisore në proceset e tyre të prokurimit mund të gjejnë masa plotësuese dhe mbështetëse:

- HAPI 1 - Vlerësimi i situatës aktuale të plastikës njëpërdorimëshe në prokurimet e organizatës
- HAPI 2 - Vlerësimi i sistemeve dhe infrastrukturës së trajtimit të mbetjeve
- HAPI 3 - Vlerësimi i kornizës ligjore të prokurimit publik
- HAPI 4 - Bashkëpunimi me tregun dhe palët e tjera të interesit për të identifikuar dhe zhvilluar alternativa
- HAPI 5 - Përshtatja dhe implementimi i opsioneve specifike të prokurimit publik
- HAPI 6 - Përpunimi i kritereve të prokurimit publik të gjelbër (PGjP)
- HAPI 7 - Sigurimi i trajnimeve për menaxherët e kontratave, stafin e prokurimit, kontraktorët dhe nën-kontraktorët
- HAPI 8 - Ndërgjegjësimi, komunikimi dhe nxitja e një pjesëmarrjeje më të gjerë
- HAPI 9 - Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve
- HAPI 10 - Monitoroni, rishikoni dhe përshtatni

Hapat plotësohen me informacion shtesë të dhënë në shtojca: Shtojca I ofron një model të politikës për të kufizuar prokurimin dhe përdorimin e plastikës njëpërdorimëshe; Shtojca II harton kritere të ndryshme që do të futen në prokurimin publik për secilin nga sektorët kryesorë të udhëzimeve; Shtojca III paraqet shembuj të ndryshëm për të ilustruar një larmi hapash dhe veprimesh të mundshme; dhe Shtojca IV jep përkufizime për disa nga termat e përdorur në udhëzime.

Detajet për secilin hap të lartpërmendur do të paraqiten më poshtë.

2.1. Masat paraprake (hapi 1, 2, 3 dhe 4)

Hapi 1 Vlerësimi i situatës aktuale të plastikës njëpërdorimëshe në prokurimet e organizatës

Duke pasur parasysh se çdo organizatë ka mënyrën e saj të kontraktimit dhe organizimit të furnizimeve, pika fillestare duhet të jetë; të ketë një pamje të qartë të llojit të plastikës njëpërdorimëshe të blerë, përdorur ose menaxhuar në operacionet, blerjet dhe kontratat e organizatës.

Një hartëzim dhe vlerësim fillestar i të gjithë artikujve plastik dhe paketimeve të përdorura ose të gjeneruara gjatë furnizimeve, shërbimeve dhe punëve duhet të kryhet për të identifikuar se ku është e pranishme plastika njëpërdorimëshe nga cilat materiale është prodhuar, për çfarë përdoren, si menaxhohen dhe cili është perceptimi i stafit dhe përdoruesve. Në këtë proces duhet të përfshihen, promovuesit e kontratave dhe menaxherët, kontraktorët aktualë dhe përdoruesit/ përfituesit.

Kjo do të ndihmojë për të përqendruar aktivitetet e angazhimit të palëve të interesuara për të identifikuar alternativat e mundshme, për të planifikuar masat që do të zbatohen dhe madje edhe për të vendosur objektiva sasiorë të parandalimit dhe një bazë fillestare për të monitoruar progresin. Ky hulumtim mund të shoqërohet me veprime ndërgjegjësuese për të hapur rrugën përpara miratimit të opsionit të politikave.

Boks I. Hartografimi i përdorimit të plastikës në Fredrikstad (Norvegji)

Bashkia e Fredrikstad hartografoi në vitin 2018 të gjitha zonat që përdorin plastikë në bashki me qëllim të përcaktimit të masave më të mira për ti përfshirë ato në Planin e Tyre të Veprimit Kundër Plastikës. Plani u zhvillua nga Agjencia e Mjedisit dhe Zhvillimit Urban dhe u vendos në departamente të ndryshme, përfshirë departamentin e blerjeve.

Më shumë informacion këtu (në Nrovegjisht)

Hapi 2 Vlerësimi i sistemeve dhe infrastrukturës së trajtimit të mbetjeve

Përveç masave për të minimizuar mbetjet plastike njëpërdorimëshe (përmes minimizimit, ripërdorimit, etj.), Disa masa përqendrohen në zgjedhjen e atyre materialeve që janë më të riciklueshme ose janë të kompostueshme dhe duke siguruar grumbullimin dhe trajtimin e tyre në mënyrë të diferencuar. Zgjedhja e një alternative apo një tjetre do të varet nga lloji i grumbullimit të diferencuar dhe trajtimit të mbetjeve të aplikuar në vend ose rajon, si dhe nga sistemi i ndarjes së mbetjeve të organizatës. Nuk ka sens ti japësh përparësi masave për riciklim apo kompostim nëse nuk ka objekte të cilat bëjnë të mundur riciklimin dhe kompostimin e tyre, nuk ka një sistem grumbullimi të diferencuar dhe nuk ka një sistem shënjimi të saktë për llojin e plastikes. Për më tepër, mund të përkeqësojë problemin ekzistues të depozitimit të pakontrolluar të plastikës dhe të krijojë probleme për riciklimin. Pra, është e nevojshme të verifikoni se cilat materiale mund të trajtohen siç duhet në rajon. Përfshirja e menaxherëve të objekteve publike, firmave të grumbullimit të mbetjeve dhe menaxherëve të infrastrukturës për trajtimin e mbetjeve duhet të konsultohet në të gjithë zonën që do të mbulohet nga opsioni i politikave.

Plastikat e kompostueshme kanë një rëndësi të veçantë sepse ato janë të dizajnuara për tu biodegraduar në kushtet e kompostimit industrial (dhe në pak raste në shtëpi), e për këtë arsye nevojitet një sistem i menaxhimit të mbetjeve ku mbetjet organike diferencohen dhe trajtohen veçmas. Në mungesë të këtij sistemi, plastika e kompostueshme nuk do të zgjidhë problemin e depozitimit të pa kontrolluar të sajë në mjedis. Aktualisht, nuk ka asnjë material plastik, të prodhuar nga burime fosile dhe as nga produkte me bazë të biodegradueshme, i cili lejon biodegradimin në mjedis brenda një periudhe kohe të arsyeshme.

Boks II. Menaxhimi i mbetjeve të plastikës në Shqipëri, Bosnje Hercegovinë dhe Mal të Zi

Shkaku kryesor i ndotjes plastike gjendet në vonesat dhe boshllëqet në menaxhimin e mbetjeve plastike në shumicën e vendeve të Mesdheut. Një studim i kohëve të fundit i porositur nga QRA / KPQ në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi për të adresuar në mënyrë specifike paketimin plastik të ushqimit dhe pijeve (PPUP)[19], tregon se sasi të mëdha të PPUP nuk kapen nga sistemet ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve, duke çuar në sasi të konsiderueshme të depozitimit të pa kontrolluar të paketimit plastik në mjedis. Për më tepër, pjesa më e madhe e mbetjeve të PPUP përfundon në vend depozitime (shpesh jo sanitare), si mbetje të ngurta bashkiake. Pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit dhe infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve, veçanërisht në zonat urbane, përqindjet e mbetjeve të PPUP të ndara për riciklim janë pothuajse të papërfillshme në të tre vendet. Shqipëria përmban shkallën më të lartë të riciklimit, kryesisht për shkak të një sistemi të madh ricikluesish informal. Në këtë kontekst, masat duhet të përqendrohen së pari në zvogëlimin e përdorimit dhe blerjes së sendeve plastike njëpërdorimëshe dhe në promovimin e alternativave të ripërdorshme, ndërsa një sistem më i mirë i menaxhimit të mbetjeve është implementuar.

Në rast se një sistem menaxhimi i mbetjeve të biodegradueshme është i ngritur/operativ dhe ai pranon plastikë të prodhuar me material bio, kriteret e gjelbërta të prokurimit publik duhet të kërkojnë që këto materiale të jenë në përputhje me standardet e biodegradueshmërisë (p.sh. EN13432) për të shmangur pretendimet e rreme mbi biodegradueshmërinë e produktit. Për të kontrolluar përputhshmërinë me standardet dhe normat, vendet duhet të sigurojnë burimet e duhura njerëzore si dhe ti vënë atyre në dispozicion mjetet e nevojshme teknike për të testuar në vend nëse plastika është apo jo e biodegradueshme. Ngritja e kapaciteteve dhe shkëmbimi i njohurive dhe praktikave mund të promovohen ndërmjet vendeve.

Boks III. Menaxhimi i mbetjeve organike në Mesdhe

Në nivelin e vendeve të Mesdheut, vetëm Franca dhe Italia llogariten të kenë aktualisht një sistem të menaxhimit të mbetjeve organike, kështu që nuk ka kushte të mundshme për futjen e plastikës së kompostueshme në rajon dhe masat duhet të përqendrohen në strategji të tjera prioritare, sesa në promovimin e artikujve të plastikës me bazë bio dhe paketimit.

Megjithatë, do të ishte e nevojshme të ngrihen kapacitetet e administratës dhe përdoruesve në lidhje me nocionet e biodegradueshmërisë, pasi ka shumë keqkuptime në shumë vende; dhe veçanërisht në depozitimin e këtyre materialeve pasi paketimi ose sendet plastike të kompostueshme mund të perceptohen si një opsion i padëmshëm për mjedisin, duke nxitur kështu sjellje mashtruese të cilat do të çonin në rritjen e numrit të këtyre materialeve të depozituara në mënyrë të pa kontrolluar.

Hapi 3 Vlerësimi i kornizës ligjore të prokurimit publik

Se si do të shmangen plastikat njëpërdorimëshe përmes prokurimit publik, do të varet, pjesërisht nga kuadri ligjor për prokurimet publike, i vendit përkatës. Disa masa do të konsistojnë në eleminimin ose zëvendësimin e sendeve të caktuara që nga fillimi gjatë vlerësimit të nevojave të prokurimit dhe përcaktimit të dokumenteve të tenderit ose urdhrave të blerjes - për shembull të kërkohen sende të ripërdorshme në një shërbim kateringu për një konferencë në vend të

19. SCP/RAC (2019). Fushat prioritare të ndërhyrjes për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve detare nga paketimet plastike në sektorin e ushqimit dhe pijeve në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi.
http://www.cprac.org/docs2/91216_priority_areas_alb_0.pdf

atyre të depozitueshme ose të siguroni ujë rubineti në gota të ripërdorshme për folësit në vend të shisheve individuale dhe gota plastike. Në këto raste, kuadri ligjori prokurimit nuk do të përbëjë një problem të madh. Sidoqoftë, në raste të tjera, kriteret për të zvogëluar plastikën njëpërdorimëshe mund të mos përcaktohen si specifikime të detyrueshme, por të promovohen përmes kritereve të vlerësimit, veçanërisht kur nuk e dimë se si do të përgjigjet tregu ose nëse tashmë e dimë se nuk ka një ofertë të madhe të tregut dhe ne duam të inkurajojmë ndryshimin dhe të tërheqim tregun drejt alternativave më të gjelbra përmes proceseve të prokurimit.

Për këtë arsye, do të jetë e nevojshme të rishikohet kuadri aktual ligjor i prokurimit në vend për të kuptuar se si mund kryhet integrimi i kritereve mjedisore në proceset e prokurimit, edhe kur nuk përmendet në mënyrë specifike dhe cilat ndryshime mund të kërkohen për të lehtësuar këtë proces. Kjo do të shërbejë gjithashtu për të përcaktuar masat specifike dhe kriteret e PGJP që do të zbatohen në hapin 5 dhe 6.

Në këtë proces është e rëndësishme të përfshihen departamentet ose agjensitë përgjegjëse për legjislacionin / kontrollin / mbështetjen e prokurimit publik, pasi stafi i përfshirë në prokurimin publik është tradicionalisht i kujdesshëm dhe konservator kur bëhet fjalë për prezantimin e ndryshimeve dhe inovacioneve në mënyrën se si të mirat, shërbimet dhe punimet kontraktohen. Për këtë arsye, një rezistencë e brendshme mund të lindë edhe kur kuadri ligjor e lejon atë, por nuk e përmend në mënyrë të qartë. Ky hulumtim mund të shoqërohet edhe me veprime ndërgjegjësuese, në mënyrë që të lehtësojë rrugën përpara miratimit të opsionit të politikave.

Hapi 4 Bashkëpunimi me tregun dhe palët e tjera të interesit për të identifikuar dhe zhvilluar alternativa

Para se të vendoset ndonjë masë, është e rëndësishme që të angazhohen dhe koordinohen punët me grupet e ndryshme të interesit për të vendosur mbi mënyrën më të mirë dhe alternativat e plastikës njëpërdorimëshe bazuar në kontekstin kombëtar dhe organizativ, kërkesat e përdoruesve / shëndetit / sigurisë, etj. Çdo proces i prokurimit publik kërkon koordinimin e kërkesës (njësive publike) dhe furinizuesve (kontraktuesve) të tregut. Këto dy aspekte duhet të shkojnë paralelisht dhe duhet të rriten në mënyrë të barabartë për kalimin efektiv të alternativave ndaj plastikës njëpërdorimëshe. Në këtë proces, zgjidhjet inovative mund të inkurajohen dhe zhvillohen për të arritur qëllimin e politikës. Kjo mund të jetë pjesë e aktiviteteve ekzistuese, mekanizmave dhe instrumenteve ekonomike në kuadrin e strategjive ekzistuese të Zhvillimit të Qëndrueshëm / Ekonomisë Qarkulluese / Rritjes së Gjelbër.

Boks IV. Gjetja e zgjidhjeve alternative kundrejt paketimit për ushqim me porosi në Spitalin e Zumárraga (Spanjë)

Spitali i Zumárraga po zbaton zgjidhje të ndryshme për të zvogëluar konsumin e paketimeve plastike njëpërdorimëshe nga pacientët dhe vizitorët e tyre. Me qëllim të gjetjes së alternativave të paketimit plastik për ushqimin me porosi të shërbyer në kantinën e spitalit, organizata hyn në dialog me kompaninë që ofron shërbimin e ushqimit në kantinën e spitalit për të gjetur alternativa për një material më të riciklueshëm. Mbas dialogut kompania propozoi të zëvendësojë paketimin plastik me paketimin prej letre/kartoni, i cili pranohet në sistemin e grumbullimit të mbetjeve organike në Vendin Bask.

Siç është përmendur edhe në Udhëzimet për të Nxjerrë jashtë përdorimit Qeset Plastike Njëpërdorimëshe në Mesdhe[20], çështje për diskutim mund të jetë lloji i materialeve që duhet të promovohen si alternativë e plastikës njëpërdorimëshe. Nuk ka një zgjidhje që i shkon përshtat të gjithëve. Një qasje e mirë mund të jetë përdorimi i Analizës së Ciklit të Jetës (ACJ) për të krahasuar opsione të ndryshme, veçanërisht kur krahasohen materialet alternative. Sidoqoftë, ACJ-a ka kufizime në mënyrën se si ajo përfshinë ndikime të caktuara duke përfshirë mbetjet e depozituara në mënyrë të pa kontrolluar në mjedis. Megjithatë, sa më shumë angazhim për të minimizuar plastikën njëpërdorimëshe dhe për të rritur ripërdorimin, aq më i vogël do të jetë ndikimi i saj në mjedis.

Për më tepër, aspektet socio-ekonomike dhe institucionale duhet të analizohen gjithashtu në mënyrë që të njihen me mënyrën se si një masë do të zbatohej dhe efektet e mundshme që mund të ketë ajo tek administrata, përdoruesit/përfituesit dhe industria/ kontraktorët duke marrë parasysh të gjitha fazat e ciklit jetësor të alternativave nga prodhimi i tyre deri në përfundim të ciklit të tyre.

20. Udhëzues për të zvogëluar qeset plastike njëpërdorimshe në Mesdhe. http://www.cprac.org/sites/default/files/otherfiles/11_guidelines_supb_en_0.pdf. Miratuar në COP21 të Konventës së Barcelonës (Napoli, 2-5 Dhjetor 2019) si Vendim IG.24/11: Udhëzues: Adopto një Plazh, Elimino Qeset plastike Njëpërdorimëshe; Sigurimi i Objekteve Pritëse në Porte për Grumbullimin e Mbetjeve të Gjeneruara në Anije; Zbatimi i tarifave me Kosto të Arsyeshme për Përdorimin e objekteve Pritëse të Portit

Grupet e ndryshëm të interesit të cilat duhet të përfshihen: financues dhe mbajtës të buxhetit, përdorues/përfitues të shërbimit, menaxherë ekzekutiv, departamente teknike të prokurimit, menaxherë të institucioneve, ndërmarrje të trajtimit të mbetjeve dhe agjentë të sektorit privat (si prodhuesit ashtu edhe ofruesit e shërbimeve).

2.2 Miratimi dhe implementimi i opsioneve specifike të prokurimit publik (hapat 5, 6 and 7)

Hapi 5 Përshtatja dhe implementimi i opsioneve specifike të prokurimit publik

Pas këtyre hapave paraprake, opsioni i politikës mund të hartohet, miratohet dhe zbatohet, në konsultim me palët kryesore të interesuara.

Nga përvoja e qeverive të tjera, mënyra më efektive është të miratohet një politikë / instrument rregullues specifik për të zvogëluar prokurimin dhe përdorimin e plastikës së depozitueshme, e cila mund të miratohet nën ombrellën e një prokurimi publik ekzistues gjelbër / të qëndrueshëm (PGjP / PQP)) politikën / planin / rregulloren nëse është e mundur. Nëse po zhvillohet një politikë e tillë gjithëpërfshirëse e PGjP / PQP, plastika njëpërdorimëshe mund të përfshihet në të si një fushë me përparësi për të siguruar që ky aspekt të adresohet siç duhet gjatë zbatimit të politikave.Kjo qasje mund të përdoret gjithashtu nëse një politikë gjithëpërfshirëse për të trajtuar plastikën njëpërdorimëshe ose për të promovuar një ekonomi qarkulluese është duke u hartuar.

Boks V. Qasje të ndryshme në Sllovaki dhe Belgjikë (rajoni i Flanders)

Qeveria e Sllovakisë ka një Plan të Tretë Kombëtar të Veprimit për PGjP për 2016-2020 dhe në këtë kuadër, Ministria Sllovake e Mjedisit miratoi në vitin 2018 një urdhër ministror për të shmangur plastikën njëpërdorimëshe. Urdhri ndalon blerjen e ujit në shishe për takime dhe qëllime të tjera nga Ministria dhe kompanitë ose agjensitë e saj publike. Në vend të paketimeve njëpërdorimëshe , uji i rubinetit duhet të shërbehet në kana, përveçse në ato rrethana kur nuk ka ujë të rubinetit në ambientet e disponueshme.

Rajoni i Flanders (Belgjikë) ka një Plan Strategjik të Prokurimit Publik (2016-2020) me një objektiv për të arritur 100% PQP (Prokurimi i Qendrueshëm Publik) në rajon. Qeveria e përdor këtë politikë gjithëpërfshirëse për veprimet e saj të PQP-së, por gjithashtu përfshin kërkesat e PGjP-së në politika të tjera relevante. Për plastikën njëpërdorimëshe, Qeveria Flamane miratoi në vitin 2019 një politikë gjithëpërfshirëse për të promovuar ekonominë qarkulluese në rajon duke u përqëndruar në menaxhimin e qëndrueshëm e materialeve dhe mbetjeve, brenda së cilës qeveria vendosi objektiva të rrepta për të zvogëluar plastikën njëpërdorimëshe në shërbimet e kateringut apo shërbime të lidhura.

Duke pasur të dy politikat PGjP/ PQP, në Sllovaki Ministria miratoi një urdhër ministror specifik për të adresuar plastikën njëpërdorimëshe përmes prokurimit, ndërsa në Flanders objektivat specifikë u përfshinë në një politikë gjithëpërfshirëse të “ekonomisë qarkulluese”.

Instrumenti rregullues / politik mund të jetë ose vullnetar ose i detyrueshëm, një kombinim i të dyjave ose i një përparimi. Kjo do të varet, ndër të tjera nga kuadri ligjor i prokurimit, përvoja / politikat ekzistuese për PGjP / PQP, alternativat e paraqitura të konsiderohen së bashku me kapacitetin e tregut dhe atë socio-ekonomike. Të gjitha informacionet e mbledhura më parë do të ndihmojnë për të vendosur se cilat alternativa duhet ti jepet më përparësi dhe

të formojnë përmbajtjen e politikës. Qeveria mund të marrë parasysh elementët e mëposhtëm:

- Autoritetet publike që i nënshtrohen politikës.
- Lloji i kontratave dhe blerjeve (grupet e produkteve) të mbuluara nga politika.
- Masat / kriteret / kërkesat që duhet të zbatohen.
- Instrumente ekonomike për të inkurajuar zbatimin e masave të caktuara nga përdoruesit.
- Përjashtime dhe periudhat e zbatimit se kur ato do të zbatohen.
- Përgjegjësitë dhe mekanizmat e monitorimit / kontrollit.
- Niveli i zbatimit të politikës, duke mbajtur parasysh aftësinë e disponueshme të zbatimit.

Një model tip për këtë lloj instrumenti rregullator është përfshirë në Shtojcën I të këtij dokumenti.

Në këtë proces, zbatimi i projekteve pilot më parë mund të ndihmojë në një përcaktimin më të mirë të opsionit përfundimtar.

Hapi 6 Përpunimi i kritereve të prokurimit publik të gjelbër (PGjP).

Sido që të jetë, si pjesë e politikës / instrumentit rregullues të prokurimit publik, ose si dokument/a i veçantë, qeveritë duhet të përcaktojnë kërkesat specifike për t'u zbatuar në grupet e produkteve me përparësi, në mënyrë që të mbështesin dhe lehtësojnë zbatimin. Duke marrë parasysh hapin 4, kriteret e PGjP-së duhet të ndjekin hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve të parashikuar në seksionin 1.2, i cili jep përparësi në këtë rend:

- Eliminimi / kufizimi i prokurimit dhe përdorimit njëpërdorimëshe dhe oxo-plastikës
- Përdorimi i alternativave të ripërdorshme kur është e mundur
- Përzgjedhja e materialeve më të riciklueshme/ kompostueshme ose materialeve me përmbajtje materiali të riciklueshëm
- Grumbullimi dhe trajtimi efektiv i mbetjeve të ndara

Një përmbledhje e kritereve të mundshme dhe shembuj real janë dhënë përkatësisht në Anekset II.

Kriteret mund të përfshijnë stimuj/inkurajime financiare për përdoruesit përfundimtarë (të tilla si pagesa shtesë për materialet e depozitueshme ose skemat e kthimit të depozitave) për të inkurajuar ndryshimin e sjelljes.

Përgatitja e kritereve të PGjP është e dobishme gjithashtu për të lehtësuar zbatimin nga organizata të tjera publike dhe private të interesuara për të kontribuar në trajtimin e plastikës njëpërdorimëshe, kur ato nuk janë pjesë e fushës së politikës.

Hapi 7 Sigurimi i trajnimeve për menaxherët e kontratave, stafin e prokurimit, kontraktorët dhe nën-kontraktorët.

Përveç politikës dhe kritereve për t'u zbatuar, personeli, si dhe kontraktorët e mundshëm dhe nën-kontraktorët do të kërkojnë trajnime, veçanërisht nëse kanë pak përvojë në prezantimin e kritereve mjedisore në prokurimin publik. Për këtë arsye, duhet të zhvillohen seksione trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të stafeve të cilët punojnë në këto sektorë. Trajnimet të cilat i drejtohen autoriteteve publike mund të jenë të hapura për të gjithë sektorin publik, pavarësisht nga fushëveprimi i politikës/instrumentit rregullator për të inkurajuar zbatimin e mëtejshëm dhe sigurimin e një sinjali të fortë për tregun.

2.3. Masa shoqëruese (hapat 8, 9 dhe 10)

Hapi 8 Ndërgjegjësimi, komunikimi dhe nxitja e një pjesëmarrjeje më të gjerë

Të gjitha veprimet që kërkojnë ndryshimin e procedurave ose zakoneve kërkojnë fushata të rregullta ndërgjegjësimi, komunikim të vazhdueshëm dhe pjesëmarrje për të mbështetur pronësinë, shmangur rezistencën dhe për të arritur rezultate më të mira veçanërisht në sektorë të tillë si sektori i hotelierisë dhe turizmit në të cilin do të ketë një përfshirje të përdoruesve. Për këtë arsye është e rëndësishme të mbahet një komunikim aktiv dhe të përfshihen të gjitha palët e interesuara (përfshirë përdoruesit/përfituesit) në çdo politikë që aplikohet/përcaktohet.

Masat e tilla duhet të zbatohen në ndërthurje me blerjet aktuale dhe proceset e tenderimit. Kur vjen puna tek zbatimi, disa masa mund të jenë parashikimi i kritereve PGjP-ë dhe burimeve të tjera përmes faqes së internetit ose krijimi i një shërbimi të ndihmës nëpërmjet postës elektronike për tu siguruar mbështetje personave apo kompanive të cilat kanë nevojë. Për të bërë të mundur një implementim të qetë dhe përftuar rezultate të mira, masat mund të përfshijnë fushata ndërgjegjësimi dhe komunikimi, shpërndarjen e artikujve të ripërdorshëm, organizimin e punëve në grup/ëorkshopeve, seminareve dhe trajnimeve si për

sektorin publik ashtu edhe atë privat, si dhe promovimin e aksioneve vullnetare, marrëveshjeve dhe iniciativave për të inkurajuar aktorë të tjerë si autoritetet kombëtare, ndërmarrjet, organizatat joqeveritare dhe qytetarët të bashkohen dhe në këtë mënyrë të zgjerojnë kërkesën dhe të stimulojnë transformimet e tregut.

Komunikimi mund të luajë një rol të rëndësishëm në përcjelljen e mesazhit për të gjithë aktorët, në mënyrë që ata të kuptojnë shqetësimin dhe të ndihen të motivuar për të zbatuar praktikat e reduktimit të mbetjeve. Ky komunikim mund të bazohet në efektet pozitive në drejtim të përfitimeve ekonomike dhe mjedisore që ka zbatimi i këtyre praktikave sesa në efektet negative që plastika njëpërdorimëshe shkakton.

Boks VI. Masat mbështetëse në Vendimin për të reduktuar plastikën njëpërdorimëshe në departamentet qeveritare, organet publike dhe shkollat në Irlandë

Në Vendimin e vitit 2019 të Qeverisë së Irlandës për të reduktuar plastikën njëpërdorimëshe, qeveria parashikon masa të ndryshme mbështetëse për zbatimin e vendimit. Këto përfshijnë: i) publikimin e burimeve përmes Departamentit të Komunikimit, Aksionit për Klimën dhe Mjedisin nëpërmjet uebfaqes pasi të jenë ngritur; ii) sigurimi i një zyre për ndihmë nëpërmjet postës elektronike për të mbështetur personelin e departamenteve të ngarkuar me zbatimin e vendimit; 3) organizimi i një trajnimi për stafin e i cili do të lehtesojë implementimin e këtij vendimi; iv) dhe konsiderimi i masave të tjera për ato Departamente të cilat kanë një numër organesh publike nën kujdesin e tyre të cilat kanë të ngjarë të kërkojnë mbështetje të veçantë në ndarjen e informacionit në lidhje me vendimin.

Hapi 9 Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve

Siç u përmend edhe më herët, përmirësimi i niveleve të grumbullimit të diferencuar dhe riciklimit është pjesë e strategjisë për të zvogëluar depozitimin e plastikës në mënyrë të pakontrolluar në mjedis. Edhe nëse plastika njëpërdorimëshe hiqet nga tregu, zëvendësuesit e saj të ripërdorshëm ose të përbërë nga materiale alternative (siç është plastika e kompostueshme) duhet të mblidhen, menaxhohen dhe trajtohen në mënyrë korrekte për të siguruar ripërdorimin dhe shmangien e depozitimit në mënyrë jo korrekte.

Bashkëpunimi i mëtejshëm midis prodhuesve dhe ricikluesve duhet të forcohet për të siguruar nivele më të larta riciklimi. Kjo mund të mbështetet duke miratuar skema të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit në vend ose duke i nxitur ato nëse ato ekzistojnë.

Nëse plastika e kompostueshme vlerësohet si një alternativë e vlefshme për disa aplikime, një kusht i domosdoshëm përpara se të promovohet ky material i ri do të jetë sigurimi i një sistemi të menaxhimit të mbetjeve për të grumbulluar dhe trajtuar atë si mbetje bio. Projektet pilot të cilat promovojnë kompostimin në shtëpi dhe atë industrial mund të zbatohen për të vlerësuar realizueshmërinë e tij.

Për këtë arsye, paralelisht me prokurimin publik, veprimet duhet të vazhdojnë të zbatohen për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve, veçanërisht në drejtim të grumbullimit të diferencuar dhe trajtimit të tyre përmes skemave të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, skemave të rimbursimit të depozitës dhe sistemeve të seleksionimit dhe grumbullimit të mbetjeve, sistemeve të riciklimit, ndalimin në rang kombëtar të prodhimit të produkteve të caktuara (të tilla si oxo-plastika), ndër të tjera. Kjo do të mundësojë rritjen e kapaciteteve për t'u marrë me plastikën njëpërdorimëshe nga minimizimi/parandalimi deri tek riciklimi dhe trajtimi përfundimtar.

Step 10 Monitoroni, rishikoni dhe përshtatni

Si përfundim, është e rëndësishme të krijoni një sistem monitorimi të bazuar në tregues të qartë të performancës për të vlerësuar progresin dhe efektivitetin e masave të zbatuara në mënyrë që të vlerësoni suksesin, të identifikoni sfidat me të cilat përballeni dhe të përmirësoni zbatimin dhe përparimin e mëtejshëm. Posaçërisht për masat e politikave për të monitoruar progresin e bërë në blerjen e një plastike njëpërdorimëshe dhe alternativave të zbatuara me kalimin e kohës (bazuar në objektiva të përcaktuara-, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata).

Për shembull, departamenteve të prokurimit publik mund t'u kërkohet të raportojnë në një periudhë të caktuar kohore rreth proceseve të tenderimit dhe blerjeve, përfshirë kriteret për të zvogëluar prokurimin dhe përdorimin e plastikës njëpërdorimëshe në kontratat dhe agjencitë e përcaktuara nga politika. Bazuar në këtë qasje, nëse objektivat nuk janë përmbushur, duhet të kryhet një rishikim për të përmirësuar zbatimin, për të miratuar masa shtesë ose për të përshtatur qasjet.

Kjo mund të shërbejë gjithashtu për të vlerësuar përfitimet e arritura dhe për ti raportuar ato tek grupet e interesit.

Shtojca I

Një model tip për instrumentin rregullator : Politika për të kufizuar blerjen dhe përdorimin e plastikës njëpërdorimëshe



SHËNIM

Kjo Shtojcë paraqet një model tip për të përpunuar një politikë e cila shërben për të adresuar plastikën njëpërdorimëshe tek autoritetet publike.

Çdo seksion i instrumentit rregullator shpjegohet me gërma italike dhe propozohen disa formulime specifike. Teksti në kllapa mund të përshtatet sipas nevojave të promovuesit të instrumentave.

Ky tekst është hartuar duke marrë parasysh shembuj konkret nga autoritetet publike të përmendura në vijim, të përfshira në Shtojcën III:

- Marrëveshje për të zvogëluar përdorimin e disa produkteve plastike njëpërdorimëshe në Qeverinë Katalanase, Spanjë, 2019 (në gjuhën Katalanase)

- Udhëzim në lidhje me shishet e ujit dhe gotat plastike njëpërdorimëshe dhe artikuj të tjerë në administratën bashkiake të Barcelonës, Spanjë, 2019 (në gjuhën Katalanase).

- Politika për të kufizuar prokurimin dhe përdorimin e plastikës njëpërdorimëshe në Departamentin e Peshkimit dhe Oqeanit të Qeverisë së Kanadasë, Kanada, 2019 (në anglisht).

Parathënie

Ky seksion mund të përmbajë informacione në lidhje me motivimin dhe sfondin për miratimin e dispozitave të detajuara më poshtë, si dhe procesin e konsultimit dhe miratimit. Kjo do të varet plotësisht nga konteksti kombëtar i secilit shtet.

Neni 1. Objektivi

Ky artikull mund të tregojë qëllimin e instrumentit rregullator. Në përgjithësi, objektivi i reduktimit të plastikës njëpërdorimëshe duhet të adresohet. Formulimi i mëposhtëm është dhënë si shembull.

Ky [emri i instrumentit rregullator] synon të adoptojë masa për të zvogëluar prokurimin dhe përdorimin e paketimeve plastike njëpërdorimëshe dhe artikujve në mënyrë që të parandalojë ndikimet negative që sjellin mbetjet plastike në mjedis, shoqëri dhe ekonomi.

Neni 2. Fusha e aplikimit

Ky artikull mund të përcaktojë administratat dhe llojin e prokurimeve kur dispozitat zbatohen. Nëse ekziston një prokurim publik i gjelbër ose një prokurim publik i qëndrueshëm, referenca për këtë mund të përfshihet këtu. Propozohet formulimi vijues.

Ky [emri i instrumentit rregullator] vlen për të gjitha departamentet e [emri i organizatës] dhe organet e tij të sektorit publik.

Kërkon reduktimin e paketimit plastik njëpërdorimësh dhe produkteve në objektet që menaxhohen nga departamentet dhe entitetet e përmendura më lart dhe ngjarjet e organizuara prej tyre. Kjo përfshin:

1. Pajisjet e nevojshme për aktivitetet e tyre të përditshme.
2. Shërbimet e kateringut dhe shitjet të cilat kryhen në ambientet e tyre.
3. Takime dhe evente publike të organizuara prej tyre.

Kjo vlen për të gjitha objektet dhe blerjet të menaxhuara ose të drejtuara direkt dhe indirekt, me përjashtim të rasteve kur lindin problematika specifike të lidhura me shëndetin, higjienën ose sigurinë.

[Emri i instrumentit rregullator] lëshohet nën [emrin e politikës gjithëpërfshirëse të prokurimit të gjelbër publik ose të qëndrueshëm], i cili kërkon që [emri i organizatës] të përfshijë elemente mjedisore në proceset e tij të prokurimit.

Neni 3. Përkufizimet

Ky artikull do të përfshijë përkufizimin e atyre koncepteve të janë të përfshira në instrumentin rregullator të cilat janë të rëndësishme për të bërë të mundur një kuptim të qartë të llojeve të ndryshme të plastikës dhe masave të përfshira në të. Referenca për çdo instrument ligjor ekzistues që përmban përkufizime përkatëse për fushën e këtij instrumenti gjithashtu mund të përfshihet.

[Referenca ndaj çdo instrumenti ligjor ekzistues që përmban përkufizime përkatëse për fushën e këtij instrumenti ligjor]

a) "Plastik": material i përbërë nga ndonjë prej elementëve të një game të gjerë të përbërjeve organike sintetike ose gjysmë sintetike të cilat janë të lakueshëme të cilatë në këtë mënyrë mund të modeloen në objekte të ngurta.

b) "Plastik njëpërdorimëshe ose e depozitueshme": produkte ose paketime prej plastike që zakonisht përdoren vetëm një herë para se të hidhen.

c) "Plastik njëpërdorimëshe e panevojshme": plastikë njëpërdorimëshe, përbërja plastike e të cilave nuk është e nevojshme të jetë në përputhje me kërkesat e shëndetit publik, higjenës ose sigurisë.

d) "Plastik e oxo degradueshme": produkte ose ambalazhe të bëra nga materiale plastike konvencionale me aditivë kimikë që copëzohen në copa të vogla.

e) "Plastik kompostueshme": produkte ose paketime të bëra nga materiale të afta për tu biodegriduar në temperatura të larta, në tokë në kushte specifike dhe në një afat kohor, zakonisht hasen vetëm në një facilitet kompostimi industrial.

f) "Paketim primar ose për shitje": paketim i konceptuar në mënyrë që të përbëjë një njësi shitje për përdoruesin përfundimtar ose konsumatorin në pikën e blerjes.

g) "Paketim sekondar ose i grupuar": paketimi i konceptuar në mënyrë që të përbëjë në pikën e blerjes një grupim të një numri të caktuar të njësive të shitjes nëse kjo e fundit është shitur si e tillë për përdoruesin përfundimtar ose konsumatorin; ai mund të hiqet nga produkti pa ndikuar në karakteristikat e tij.

h) "Paketim terciar ose transportues": paketimi i konceptuar në mënyrë që të lehtësojë mbajtjen dhe transportimin e një numri paketimesh të grupuara për të parandaluar dëmtimin fizik gjatë transportit.

Neni 4. Masat për të zvogëluar prokurimin dhe përdorimin e plastikës me përdorim të vetëm

Ky seksion mund të përfshijë masat specifike për të shmangur blerjen dhe përdorimin e plastikës njëpërdorimëshe. Faza dhe veprime të ndryshme mund të konsiderohen, ashtu si dhe përjashtime. Shembujt dhe formulimet e mëposhtme janë sugjeruese, por masat specifike duhet të përcaktohen bazuar në kontekstin kombëtar. Shih Aneksin II për masa dhe kritere të tjera të mundshme.

Masat e mëposhtme do të duhet të zbatohen nga të gjithë organet në të gjitha blerjet dhe kontratat brenda objektit të këtij [emri i instrumentit rregullator] siç përcaktohet në nenin 2:

1. [Në të gjitha shërbimet e kateringut, është e ndaluar të shërbeni pije në paketim plastik njëpërdorimësh dhe të përdorni artikuj plastik të depozitueshëm (servise tavoline), pipëza. Në këto kontrata do të duhet të sigurohen sisteme alternative siç janë kavanoza të ripërdorshme për ujë nga rubineti, materiale për servirjen e pijeve dhe ushqimit të paketuara në materiale alternative siç janë qelqi, metali, kartoni ose materiale të kompostueshme.]
2. [Në makineritë e automatizuara për ofrimin e pijeve të ngrohta, gotat plastike njëpërdorimëshe nuk duhet të përdoren. Në vend të tyre, makinat ose do të servirin me gota letre ose, kur është e përshtatshme, të lejojnë përdoruesin të zgjedhë opsionin pa gotë për të lejuar në këtë mënyrë përdorimin e gotave të ripërdorshme të shpërndara për të gjithë stafin. Në këto makina bimodale, ofrimi i gotave do të ketë një çmim të lartë për të nxitur përdorimin e gotave të ripërdorshme.]
3. [Në makineritë e automatizuara për ofrimin e pijeve të ftohta, uji në shishe nuk do të ofrohet ose do të ofrohet vetëm në shishe një litërshe. Për pije të tjera, paketimit prej qelqi ose metali duhet ti jepet më shumë përparësi kundrejt plastikës njëpërdorimëshe.]
4. [Kontejnerë të përshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve do të instalohen pranë makinerive të automatizuara.]
5. [Në të gjitha ndërtesat (përfshirë sallat e takimeve), shishet dhe gotat plastike për ofrimin e ujit do të ndalohen. Ato do të zëvendësohen me shishe të ripërdorshme, kavanoza, gota dhe burime uji të lidhura në rrjetin e ujit të rubinetit të cilat do të jenë të disponueshëme për stafin dhe vizitorët, me një dizajn që lejon mbushjen e shisheve dhe kavanozëve të ripërdorshëm.]
6. [Në të gjitha kontratat e furnizimit të cilat lidhen në mënyrë të shpeshtë, paketimi terciar i ripërdorshëm dhe i kthyeshëm do të promovohet.]
7. [Si përfundim, në të gjitha kontratat, përdorimi i plastikës së oxo degradueshme do të ndalohet dhe masat për të minimizuar paketimin parësor dhe sekondar dhe / ose promovimin e përdorimit të materialeve të ricklueshme, kompostueshme ose riciklimi duhet të inkurajohet.]

Neni 5. Përgjegjësitë dhe pasojat

Përgjegjësitë për instrumentin rregullator dhe lloji i mospërputhjes dhe pasojat e ndërlidhura mund të specifikohen në këtë seksion. Përgjegjësitë mund të jenë nën një departament ose agjenci por mund të jetë gjithashtu një komitet drejtues ekzistues ose i ri i ngritur posaçërisht për këtë instrument rregullator. Përgjegjësi të tjera mund të përmenden këtu për shembull nga zyra e planifikimit të buxhetit, drejtorët e njësive, burimet njerëzore, etj.

Mbikëqyrja e zbatimit të [emri i instrumentit rregullator] është përgjegjësi e [emrit të departamentit të caktuar, agjencisë ose komitetit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tij].

Në rast të mosrespektimit të [emri i instrumentit rregullator], masa korrigjuese mund të kërkohet nga njësia ose entiteti përkatës për të siguruar që [emri i instrumentit rregullator] të respektohet dhe zbatohet.

Neni 6. Data e zbatimit

Ky seksion specifikon kur instrumenti rregullator hyn në fuqi. Mund të ketë një datë të vetme efektive ose një zbatim progresiv, ku disa autoritete mund të përfshihen gjithnjë e më shumë.

Ky [emri i instrumentit rregullator] hyn në fuqi në [datën e zbatimit të instrumentit].

Shtojca II

Përpilimi i kritereve të mundshme për tu përfshirë në proçeset e prokurimit

Kjo shtojcë paraqet kritere të ndryshme të mundshme për tu përfshirë në prokurimin publik për secilin nga sektorët kryesorë të udhëzimeve:

TABELA 1
Kritere për shërbimet e kateringut dhe ushqimeve

TABELA 2
Kritere për shërbimet e shitjes me makineri të automatizuara

TABELA 3
Kritere për paketimin në përgjithësi (i aplikueshëm për një sërë kontratash)

Për secilën prej tyre, jepen informacione mbi llojin e ndërhyrjes dhe praktikës, së bashku me disa shënime/komente për t'u marrë parasysh kur merret parasysh kriteri.

TABELA 1. KRITERE PËR SHËRBIMET E KATERINGUT DHE USHQIMIT

TIPI I NDËRHYRJES	TIPI I PRAKTIKËS	KRITERI	SHËNIME/KOMENTE
Reduktoni, parandaloni ose eleminoni	Eleminimi i disa produkteve ose materialeve të caktuara	Shmangni artikujt njëpërdorimsh të serviseve të tavolinës	
		Siguroni ujë rubineti (me apo pa sistem filtrimi) në vend të ujit në shishe.	
		Ofroni uji në paketime shumë litrorëshe (në gota të ripërdorshme ose qelqi) sesa në paketime individuale.	
	Minimizoni paketimin	Shmangni konservimin e produkteve (sheqer, kripë, piper etj.) në njësi individuale.	
Ripërdorimi, riparimi ose përditësimi	Përzgjidhni opsionin e ripërdorshme	Kërkoni përdorimin e servise të ripërdorshme të tavolinës (gota, enë porcelain) dhe mbulesa tavoline shumë përdorimëshe.	
Riciklimi	Materiale të ricikluara	Kërkoni që artikujt e ripërdorshëm ose artikujt njëpërdorimësh të përmbajnë një përqindje materiali të riciklueshëm.	Nëse materialet e ricikluara nuk janë ende shumë të përhapura, rekomandohet ta prezantoni atë si një kriter për tu vlerësuar me një çmim.
	Përzgjidhni materiale më të riciklueshme ose kompostueshme	Në rastet kur përdorimi i artikujve të ripërdorshëm nuk është i mundur ose rekomandohet, kërkoni përdorimin e produkteve (serviseve të tavolinës, mbulesa tavoline dhe sende të tjera) të cilat mund të kompostohen ose bazohen në lëndë të para të rinovueshme dhe që nuk janë të laminuara.	Kjo duhet të kërkohet vetëm nëse facilitetet e menaxhimit të mbetjeve mund të trajtojnë materiale të tilla (për informacione të mëtejshme, shihni Hapin 2 të udhëzimeve). Për kompostueshmërinë, kërkoni që materialet të jenë në përputhje me standardin EN 13432 ose ekuivalente, për të shmangur pretendimet e rreme.
Menaxhimi i mbetjeve	Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve	Kërkoni nga kontraktorët të kryejnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të gjeneruara gjatë shërbimit.	Kjo mund të kërkojë të përfshihet edhe komponenti i trajnimit të stafit të kontraktuar për të siguruar rezultate të mira; dhe ndërgjegjësimin e përdoruesit
Tjetër	Tjetër	Blini produkte të freskëta dhe sezonale të cilat përmbajnë minimumin e paketimit.	
		Përdorni specifikime të hapura për të përshkruar nevojën. Shembull: operimi i kantinës ku të ftuarit mund të hanë/ pinë jashtë kantinës me përdorimin minimal të plastikës për të siguruar një impakt sa më minimal të shkaktuar nga depozitimi i këtyre artikujve.	

TABELA 2. KRITERE PËR SHËRBIMET E SHITJES ME MAKINERI TË AUTOMATIZUARA

TIPI I NDËRHYRJES	TIPI I PRAKTIKËS	KRITERI	SHËNIME/KOMENTE
Reduktoni, parandaloni ose eleminoni	Eleminimi i disa produkteve ose materialeve të caktuara	Ndaloni shitjen e shisheve të ujit nga makineritë e automatizuara të shitjes dhe ofroni në vend të tij uji nga rubineti (me ose pa sistem e filtrimi) të lidhur me ujësjellësin dhe që lejojnë rimbushjen e shisheve të ripërdorshme.	Këto veprime mund të kërkojnë zbatimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe shpërndarjen e gotave dhe shisheve të ripërdorshme, si pjesë e kontratës ose si një blerje e veçantë.
		Zëvendësoni shishet shumë litrorshe për ujë (me apo pa sistem filtrimi) të lidhur me ujësjellësin dhe që lejojnë rimbushjen e shisheve të ripërdorshme	
		Kërkoni që makinat e pijeve të nxehta ose të mos servirin pije në gota njëpërdorimëshe ose të lejojnë të zgjidhni opsionin me apo pa gotë (duke mos e paracaktuar opsionin për zgjedhjen e gotës sa herë të jetë e mundur) dhe me një cmim nëse zgjedh opsionin me gotë.	
		Kërkoni kafe kokërr (jo në kapsula).	
Riciklimi	Përzgjidhni material të cilat janë më të riciklueshme ose kompostueshme	Zëvendësoni gotat plastike të depozitueshme me gota të kompostueshme ose të prodhuara nga lëndë të para të rinovueshme.	Kjo duhet të kërkohet vetëm nëse facilitetet e menaxhimit të mbetjeve të cilat mund të trajtojnë materiale të tilla (për informacione të mëtejshme, shihni Hapin 2 të udhëzimeve). Për kompostueshmërinë, kërkoni që materialet të jenë në përputhje me standardin EN 13432 ose ekuivalent, për të shmangur pretendimet e rreme.
		Zëvendësoni shkopinjtë plastik për përzierje, me shkopinj të prodhuar nga material të kompostueshme, biodegradushme ose nga lëndë të rinovueshme.	
Menaxhimi i mbetjeve	Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve	Kërkoni instalimin e makinerive të automatizuara për rikuperimin e kanaçeve dhe shisheve për qëllime ripërdorimi ose riciklimi.	

TABELA 3. KRITERE PËR PAKETIMIN NË PËRGJITHËSI (I APLIKUESHËM PËR NJË SËRË KONTRATASH) (1/2)

TIPI I NDËRHYRJES	TIPI I PRAKTIKËS	KRITERI	SHËNIME/KOMENTE
Reduktoni, parandaloni ose eleminoni	Eleminimi i disa produkteve ose materialeve të caktuara	Shmangni produktet e furnizuara në pjesë ose në njësi të vetme.	
		Shmangni paketimin i cili përbëhet nga oxo-plastika.	Kërkoni nga furnizuesit që të etiketojnë llojet e plastikës në mënyrë që të jetë më e lehtë të identifikohen llojet e tyre.
		Shmangni paketimet prej polistireni	
		Shmangni PVC-në dhe paketimet e tjera të halogjenizuara.	
	Minimizoni paketimin	Përdorni produkte të përqendruara që mund të hollohen gjatë përdorimit, nëse është e nevojshme, në enë të ripërdorshme.	Për shembull, produkte të përqendruara pastrimi që mund të hollohen në vend dhe shpërndahen në shishe të ripërdorshme.
Ripërdorimi, riparimi ose përditësimi	Përzgjidhni opsionin e ripërdorshme	Kërkoni përdorjen e paketimit të ripërdorshëm për dërgesat; ose në kontratat me gjenerim të lartë të mbetjeve nga paketimet, ndërtime dhe punime të tjera të ngjashme, kërkoni që kontraktorët të vendosin një minimum dhe një nivel të synuar për përdorimin e paketimeve/kontejnerëve të transportit të ripërdorshëm të materialeve.	
		Zëvendësoni paketimet njëpërdorimëshe me alternativa të tjera të rimbushshme.	
Menaxhimi i mbetjeve	Sistemet e kthimit të paketimit	Kërkoni nga kontraktuesit të sigurojnë opsione për kthimin e paketimit.	
	Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve	Kërkoni nga kontraktuesi që të bëjë një menaxhim të saktë të paketimit të mbetjeve të krijuara gjatë kontratës duke siguruar grumbullimin e diferencuar dhe depozitimin e tyre.	Kjo duhet të kërkohet vetëm nëse grumbullimi dhe trajtimi i diferencuar i mbetjeve ekziston në vend ose rajon.
	Miks	Në kontratat me gjenerimin e lartë të mbetjeve të paketimit si në ndërtime dhe punime të tilla, kërkoni që kontraktorët të vendosin një minimum dhe një nivel të synuar për mbetjet e paketimit (I cili të arrihet për shembull: përmes një sistemi kthimi, ripërdorimit dhe riciklimit të paketimit).	

TABELA 3. KRITERE PËR PAKETIMIN NË PËRGJITHËSI (I APLIKUESHËM PËR NJË SËRË KONTRATASH) (2/2)

Tipi i ndërhyrjes	Tipi i praktikës	Kriteri	Shënime/Komente
Riciklimi	Shmangni materialet e përbëra	Kërkoni që paketimi (veçanërisht ai i cili nuk mund të ripërdoret) të jetë i një materiali të vetëm.	
	Kërkoni çmontim të thjeshtë	Nëse paketimi nuk mund të jetë i një materiali të vetëm, sigurohuni që paketimi të shkëputet lehtësisht në materialet e tij të ndryshme për të lehtësuar ndarjen dhe riciklimin e tyre.	
	Siguroni që plastika të jetë e etiketuar	Kërkoni që paketimi të etiketohet në bazë të materialeve nga të cilat është krijuar për të lehtësuar ndarjen dhe riciklimin.	
	Shmangni substancat dëmshme	Vetëm substancat që në kohën e aplikimit i është vlerësuar rreziku dhe nuk janë klasifikuar apo kategorizuar si të rrezikshme mund të përdoren në paketimin plastik.	
	Përzgjidhni më shumë material të riciklueshme ose të kompostueshme.	Kërkoni që paketimi të mos jetë me ngjyrë të zezë ose të errët (përveç rasteve kur prodhohet nga material i ricikluar).	
		Kërkoni që paketimet të përbëhen nga materiale të cilat janë të riciklueshme me teknologjinë e zakonshme të ripërpunimit në vendin ose rajonin tuaj (kartoni, PET, PE, PP ...).	Kërkojini furnizuesve të etiketojnë llojin e plastikës në mqnyrë që të jetë më e lehtë identifikimi i atyre llojve të cilat mund të menaxhohen.
		Kërkoni paketime të kompostueshme.	Kjo duhet të kërkohet vetëm nëse facilitetet e menaxhimit të mbetjeve të cilat mund të trajtojnë materiale të tilla (për informacione të mëtejshme, shihni Hapin 2 të udhëzimeve). Për kompostueshmërinë, kërkoni që materialet të jenë në përputhje me standardin EN 13432 ose ekuivalent, për të shmangur pretendimet e rreme.
	Materialet e ricikluara	Kërkoni paketime të përbëra, të paktën pjesërisht, nga material i ricikluar	Nëse materialet e ricikluara nuk janë ende shumë të përhapura, rekomandohet ti prezantoni ato, si një kriter për të përftuar një çmim.

Shtojca III

Përpilimi i shembujve nga autoritetet publike

Shembujt e përpiluar në këtë shtojcë janë organizuar në kategoritë e mëposhtme:

- III-1. Vlerësimi fillestar
- III-2. Politikat
- III-3. Kriteret e PBB
- III-4. Prokurimi i shërbimeve të kateringut
- III-5. Prokurimi i shërbimeve të shitjes nëpërmjet makinerive të automatizuara
- III-6. Prokurimi i lidhur me organizimin e eventeve/ngjarjeve
- III-7. Prokurimi i shërbimeve të pastrimit
- III-8. Iniciativa, ndërgjegjësimi dhe komunikimi

Për secilën prej tyre, është dhënë informacion për organizatën përgjegjëse, vendin, vitin e zbatimit dhe një përshkrim i shkurtër, së bashku me një adresë/link me më shumë informacion sa herë që është në dispozicion. Për më tepër, informacioni mbi llojin e ndërhyrjes së aplikuar në secilin rast jepet gjithashtu bazuar në ikonat e mëposhtme:

Parandalim/Minimizim

Ripërdor/Modifiko/Përmirëso

Riciklim/E ricikluar

III-1. Vlerësimi fillestar

Plani i veprimit kundër plastikës i bashkisë Fredrikstad

Fredrikstad | Norvegji | 2018

Bashkia ka hartuar hartën e të gjitha zonave që përdorin plastikë për të vendosur masa konkrete. Plani u zhvillua nga Agjencia e Mjedisit dhe Zhvillimit Urban dhe u vendos në departamente të ndryshme, përfshirë departamentin e blerjeve.

Më shumë informacion këtu (në Norvegjisht)

III-2. Politikat

Politika për të ndaluar blerjen e ujit në shishe

Qeveria e Sllovakisë | Sllovaki | 2018

Prej 1 nëntorit 2018 Ministria Sllovake e Mjedisit ka miratuar politikën që ndalon blerjen e ujit në shishe për evente përfaqësuese dhe qëllime të tjeranga Ministria dhe publiku i saj. Në vend të ujit në shishe, duhet të shërbehet uji nga rubinet i servirur në kanë, me përjshtim të atyre rasteve kur nuk ka ujë nga rubineti në ambjentet në të cilat organizohet eventi.

Marrëveshje për të zvogëluar përdorimin e disa produkteve plastike njëpërdorimëshe në Qeverinë Katalanase

Qeveria e Katalonjës | Spanjë | 2019

Qeveria Katalanase ka miratuar një rregullore të brendshme për të zvogëluar përdorimin e produkteve dhe paketimeve plastike njëpërdorimëshe në departamentet dhe agjencitë qeveritare, në ndërtesat e tyre dhe ngjarjet publike përmes prokurimit publik. Kjo përfshin ndalimin e furnizimit të pijeve në kontejnerë plastikë të depozitueshëm ose përdorimin e produkteve plastike njëpërdorimëshe, siç janë seviset e ushqimit, gotat dhe përzierësit e pijeve; përdorimi i sistemeve të tjera të shpërndarjes ose materialeve alternative; dhe furnizimi me ujë në shishe të cilat përmbajnë të paktën një litër ose më shumë.

Më shumë informacion këtu (në gjuhën Katalanase)

Vendim për të ulur plastikën njëpërdorimëshe në departamentet qeveritare, organet publike dhe shkollat

Qeveria e Irlandës | Irlandë | 2019

Qeveria miratoi në 3 janar një vendim i cili deklaronte se departamentet qeveritare nuk do të blinin, drejtpërdrejt ose indirekt, shishe plastike njëpërdorimëshe për tregtimin e pijeve, serviseve të tavolinës ose pipëzave. Ky kufizim do të zbatohet gjithashtu për të gjitha organet publike, përfshirë agjensitë shtetërore dhe shkollat, përveç nëse lindin çështje specifike të lidhura me sigurinë e shëndetit, higjienës ose sigurisë.

Shembuj të tjerë të ngjashëm:

- Udhëzim në lidhje me ujin në shishe dhe gota plastike njëpërdorimëshe dhe sende të tjera në administratën bashkiake të Barcelonës, Spanjë, 2019 (në gjuhën Katalanase).
- Udhëzim në lidhje me ujin në shishe dhe gota plastike njëpërdorimëshe dhe sende të tjera në administratën bashkiake të Barcelonës, Spanjë, 2019 (në gjuhën Katalanase).
- Artikulli 5.3.12 deri 5.3.12.3 për kushtet e përdorimit të materialeve të kateringut në përputhje me Vendimin e Qeverisë Flamane për menaxhimin e qëndrueshëm të ciklit të materialit dhe mbetjeve, Flande – Belgjikë, 2019 (në gjuhën Hollandeze)

III-3. Kriteret e PGjP

Kriter i përgjithshëm për paketimet për procese të ndryshme tenderimi

Qeveria e Flanders | Beligjik | 2019

Duke marrë parasysh që shumë mallra janë paketuar për transport dhe shpërndarje, të cilat mund të kenë një ndikim domethënës mjedisor, Qeveria e Flanders ka hartuar një kriter të përgjithshëm udhëzues të PGJP-së për paketimin për t'u përfshirë në kontratat që përfshijnë shpërndarjen e mallrave.

Kriteri, i cili duhet të përshtatet rast pas rasti, i jep përparësi minimizimit të paketimit sa më shumë që të jetë e mundur dhe përdorimit të paketimeve të ripërdorshme kur paketimi është i pashmangshëm. Nëse duhet të përdoret paketimi njëpërdorimësh, kriteri promovon paketimin mono material ose materiale jo të bashkëlidhura që mund të ndahen lehtësisht me dorë, ato materiale nga plastika duhet të jenë nga llojet e plastikës me shkallë të lartë riciklimi në rajon (PET, PP, HDPE,) LDPE ose PS - si me bazë bio, ashtu edhe nga ato fosile) dhe ato nga letra / kartoni duhet të vijnë nga të paktën 70% pyje të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe / ose të ricikluara.

Më shumë informacion këtu (në gjuhën Hollandeze)

Kriter i përgjithshëm për paketimet për furnizime jo-mjekësore

Organizata shëndetësore Barrualde-Galdakao – Vendet Baske (Spanjë) | 2019

Në përpjekjet e tyre për të integruar PGjP-të në të gjitha blerjet e tyre, organizata e kujdesit shëndetësor Barrualde-Galdakao zhvilloi kritere të brendshme të PGjP-së për disa grupe produktesh. Një prej tyre është për furnizimin me mallra dhe produkte jo-mjekësore (përfshirë mobilje, këpucë, detergjentë...). Kriteret e përcaktuara, janë kriteret e dhënies së bonuseve dhe parashikojnë të japin pikë nëse: 1) produktet janë paketuar me paketim të ricikluesshëm, dhe për këtë, ata duhet të kenë shenjën Green Dot që siguron që kompania të jetë pjesë e skemës së Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit për paketimin.; dhe 2) nëse paketimi është bërë nga material i ricikluar ose nga pyje të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme. Për të parën, paketimi duhet të përfshijë rrethin Möbius me % të përmbajtjes e ardhur nga riciklimi. Për pyje të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme, ato duhet të shënohen me FSC, PEFC ose ekoetiketa të ngjashme.

Kriteret e BE-së në PGjP për ushqim, shërbime kateringu dhe makineritë e automatizuara të shitjes

Komisioni Evropian | 2019

Komisioni Evropian ka hartuar kritere PGjP për ushqimin, shërbimet e kateringut dhe makinat e automatizuara të shitjes. Në lidhje me paketimin në shërbimet e kateringut, ndër të tjera përcaktohen kriteret e mëposhtme: porositja e produkteve që nuk mund të prishen në masë, zgjedhja e paketimeve të ricikluesshme dhe kompostueshme, kthimi i paketimeve për ripërdorim, shmangia e sendeve me paketim sekondar të panevojshëm ose të tepërt, dhe vendosja e të mirave dhe ushqimeve në kontejnerë të rimbushshëm.

Më shumë informacion këtu (në anglisht për momentin por në të gjitha gjuhët e BE së shpejti)

Shembuj të tjerë të ngjashëm:

Bashkimi Evropian dhe vendet e tjera kanë zhvilluar gjithashtu kritere PGjP për grupe të ndryshme produktesh që mund të përfshijnë kritere për paketimin dhe artikuj njëpërdorimësh. Një rishikim i kritereve të ndryshme mund të bëhet për të identifikuar ato që janë më të rëndësishme për secilin autoritet.

III-4. Prokurimi i shërbimeve të kateringut

Programi eko-shkolla

Qeveria e Sllovenisë | Sllloveni | 2016

Një projekt ndërkombëtar është zbatuar në shkollat fillore dhe të mesme me qëllim përmirësimin e ushqimit të studentëve, zvogëlimin e sasisë së ushqimit të depozituar si mbetje, zvogëlimin e përdorimit të paketimeve, promovimin e zinxhirëve të furnizimit më të shkurtër, bankave të farave dhe kopshteve të shkollës, etj.

Më shumë informacion këtu (në Sllovenisht)

Shërbimi i një ushqimi më organic e të ekuilibruar në shkolla

Administrata bashkiake e Mynih-ut | Gjermani | 2018

Tenderi për kontratën kornizë për kateringun e ushqimit në shkollë përfshin një kërkesë për të shmangur materialet e paketimit sa më shumë që të jetë e mundur, me një përparësi për paketimet e ripërdorshme. Për më tepër, paketimi i depozitueshëm duhet të jetë i riciklueshëm dhe kontejnerët e ripërdorshëm duhet të jenë të disponueshëm për transport në objekt, pa depozitë ose faturë shtesë, dhe gjithashtu duhet të grumbulohen.

Më shumë informacion këtu (në anglisht)

Përgatitja dhe shpërndarja e ushqimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm në shkollë

Administrata bashkiake e Otignies | Belgjikë | 2019

Në tenderin për kateringun në objektet shkollore bashkiake u përfshinë disa kritere të qëndrueshmërisë. Disa nga kriteret i referohen minimizimit të përdorimit të plastikës njëpërdorimëshe: kompanisë fituese ju kërkua ti jepte prioritet një paketimi më miqësor ndaj mjedisit dhe duhet t'u jepte përparësi produkteve të paketuara në vëllim të madh dhe në paketimet e kthyeshme. Përveç kësaj, uji i freskët i rubinetit duhet t'u shërbehet fëmijëve dhe asnjë pije në shishe nuk lejohet

Më shumë informacion këtu (në anglisht)

Shembuj të tjerë të ngjashëm:

- Monitorimi i karbonit të ulët, shërbime të qëndrueshme të kateringut, Administrata bashkiake e Torinos, Itali, 2018 (në anglisht).
- Shërbimi eko-kateringut spitalor, Administrata bashkiake e Piemonte-s, Itali, 2018 (në anglisht).
- Gotat e ripërdorshme në shezllonët e plazhit, Administrata bashkiake e Barcelonës, Spanjë, 2018 (në gjuhën Katalanase).

III-5. Prokurimi i shërbimeve të shitjes nëpërmjet makinerive të automatizuara

Katering i qëndrueshëm e miqësor ndaj klimës

Universiteti i Bazelit | Zvicër | 2016

Universiteti i Bazelit ka prezantuar zona rimbushëse, ku përdoruesit mund të rimbushin pijet e tyre të nxehta dhe të ftohta në kontejnerë shumëpërdorimësh. Për të promovuar masën, në kafene dhe dyqane ata shesin filxhanë dhe shishe kafe të ripërdorshme).

Më shumë informacion këtu (në anglisht)

Makineri shitëse të automatizuara eko-inovative

Universiteti i Torinos | Itali | 2018

Universiteti i Torinos ka rimenduar kërkesat e tij të shitjes nëpërmjet makinerive të automatizuara në mënyrë që të stimulojë eko-inovacionin. Disa kërkesa përfshijnë sigurimin e shpërndarësve të ujit për të lejuar përdoruesit të mbushin shishet e tyre; shpërbleni/vlerësoni propozime të cilat mendojnë për menaxhimin efikas të mbetjeve dhe për rikuperimin ose ripërdorimin e llumit të kafesë; shpërbleni/vlerësoni përdorimin e shisheve të ujit nga shishet plastike të ricikluara (rPET) ose PET me bazë bio; dhe shpërbleni/vlerësoni përdorimin e makinave për bluarjen e kafes në moment (makina për bluarjen e kafes kokërr).

Më shumë informacion këtu (në anglisht)

Makina shitjeje të automatizuara në Muzeun e Shkencave të Natyrës të Barcelonës

Administrata bashkiake e Barcelonës | Spanjë | 2018

Referuar tenderit për makinat shitëse të automatizuara në Muzeun e Shkencave të Natyrës të Barcelonës, makinat e pijeve të nxehta duhet të kenë mundësinë që të ofrojnë shërbimin me ose pa filxhan, me kosto të shtuar për filxhan, në mënyrë që të favorizojnë përdorimin e filxhanëve të ripërdorshëm.

Më shumë informacion këtu (në gjuhën Katalanase)

Shembuj të tjerë të ngjashëm:

- Burime uji të pastra të lidhura me rrjetin dhe kontejnerë të ripërdorshëm në Mutualia, Spanjë, 2018 (në Spanjisht).

III-6. Prokurimi i lidhur me organizimin e eventeve/ngjarjeve

Aktivitete të gjelbërta në Kampionatin Botëror të Hokejt në Akull IIHF në 2019

Qeveria e Sllovakisë dhe Komiteti Organizues i Kampionatit | Sllovaki | 2019

Ministria Sllovake e Mjedisit në bashkëpunim me Komitetin Organizativ të Kampionatit Botëror të 2019 të Hokejt mbi Akull, IIHF, siguruan gota të ripërdorshme dhe artikuj tavoline të biodegradueshme në vend të artikujve plastik njëpërdorimsh në kafeteri, bare dhe ambjente ku servirej ushqim i shpejtë. Organizatorët kishin vendosur gjithsej 580 kontejnerë për ndarjen e mbetjeve me informacione rreth ndarjes së duhur.

Gota të ripërdorshme të përdorura në ngjarje festive të organizuara në Barcelonë

Administrata bashkiake e Barcelonës | Spanjë | 2018

Barcelona ka punuar për një kohë të gjatë në përmirësimin e qëndrueshmërisë gjatë organizimit të festave të saj dhe për vite me radhë gotat plastike të ripërdorshme janë hedhur në treg (duke përdorur një skemë të kthimit të depozitave). Vlerësohet se në vitin 2018 janë përdorur 1,004,500 gota të ripërdorshme (kjo është zbatuar edhe në objektet e tjera bashkiake si kopshti zoologjik, parqe argëtues ose në salla sportive që organizohen koncerte).

Më shumë informacion këtu (në gjuhën Katalanase)

Zëvendësimi i shisheve të ujit për gota letre në gara/ndeshje

Administrata bashkiake e Barcelonës | Spanjë | 2019

Në tenderat për organizimin e disa garave të mbështetura nga bashkia, Instituti Sportiv i Barcelonës ka kërkuar zëvendësimin e shisheve të ujit me gota letre. Vlerësohet se në vitin 2018, janë shmangur mbetje prej 64,000 shisheve plastike njëpërdorimëshe.

III-7. Prokurimi i shërbimeve të pastrimit

Prokurimi i gjelbër i produkteve të pastrimit

Administrata bashkiake e Gentit | Belgjikë | 2017

Në marrëveshjen kornizë për furnizimin e produkteve të pastrimit dhe furnizimeve sanitare, administrata bashkiake e Gentit prezantoi kritere mjedisore të tilla si përdorimi i paketave të rimbushura dhe se furnizuesi duhet të sigurojë prova që materiali i marrë është ricikluar. Për më tepër, pikë shtesë iu jepen nëse furnizuesi intensifikon përpjekjet e tij ose aplikon metoda inovative për reduktimin dhe/ose minimizimin e mbetjeve. Si rezultat, përmbajtja e ricikluesshme dhe riciklimi i mbetjeve u përmirësuan në masë të madhe: paketimi i përdorur ishte 85% kartoni i ricikluar, shishet plastike ishin bërë nga PEHD të ricikluesshme 100% dhe 10% ishte PEHD e ricikluesshme, ndërsa ato të bëra nga PET ishin 100% të ricikluesshme dhe të bëra nga 81% materiale të ricikluesshme.

Më shumë informacion këtu (në anglisht)

Prokurimi i produkteve dhe shërbimeve të pastrimit me paketim të reduktuar

Administrata bashkiake e Lolland | Danimarkë | 2011

Bashkia e Lolland ka përshtatur mënyrën prokurimit të tyre për shërbime pastrimi për nevoja operative. Për të përmirësuar efikasitetin e burimeve, produktet e pastrimit u ulën me 30-50% dhe për këtë arsye, ky optimizim pritet të reduktojë paketimin.

Më shumë informacion këtu (në anglisht)

Produkte dhe shërbime të gjelbëra të pastrimit

Qeveria e Estonisë | Estoni | 2019

Tenderi i produkteve dhe shërbimeve të pastrimit të Policisë Estoneze përfshinte kërkesa të tilla si përdorimin e kontejnerëve të rimbushshëm (përfshirë shishe me spërkatje), minimizimi i sasisë së mbetjeve të gjeneruara, përdorimi i pajisjeve dozuese dhe përdorimi i produkteve të pastrimit me ndikim të ulët mjedisor bazuar në eko-tiketat ekzistuese.

Më shumë informacion këtu (në anglisht)

III-8. Iniciativa, ndërgjegjësimi dhe komunikimi

Uebfaqja e PGjP për të promovuar aspektet mjedisore në prokurimin publik

Qeveria e Kroacisë | Kroaci | 2018

Qeveria e Kroacisë ka një faqe në internet për të komunikuar dhe promovuar kriteret e gjelbërta të prokurimit publik dhe për të bërë të njohura praktikat e mira. Shumë nga këto kritere marrin parasysh aspektet plastike të produkteve.

Më shumë informacion këtu (në Kroatisht)

Iniciativa "Pa plastikë"

Qeveria e Italisë | Itali | 2018

Ministria Italiane e Mjedisit, Mbrojtjes së Tokës dhe Detit ka filluar një fushatë për të aplikuar 4R-të (redukto, ripërdor, riciklo, rikupero) në departamentet, agjensitë dhe ndërtesat e saj. Disa nga masat e përfshira ishin instalimi i shpërndarësve të ujit të lidhur me rrjetin e ujit, shpërndarja falas e shisheve të aluminit të ricikluar për punonjësit dhe zëvendësimi i gotave të plastikës nga ato të letrës dhe i përzierësve plastik me ato prej druri në shpërndarësit e pijeve të nxehta.

Më shumë informacion këtu (në italisht)

"Fund gotave plastike të depozitueshme"



Qeveria e Qipros | Qipro | 2018

Departamenti i Mjedisit ftoi të gjitha kompanitë që ofrojnë pije në gota plastike të depozitueshme për të aplikuar metoda të reja për të zvogëluar konsumin e plastikës së depozitueshme (inkurajoni klientët të blejnë gota të ripërdorshme ose të sjellin vetë ato, duke u dhënë atyre stimulin për të marrë pije e tyre me një zbritje, ndër masat e tjera).

Shembuj të tjerë:

- Festivali juaj pa mbetje: Libërthi i zero mbetje për promovuesit e festivalit dhe eventit, Qeveria e Sllovakisë, Sllovaki, 2018.8.
- Fushata për të promovuar zvogëlimin e mbetjeve të shisheve prej qelqi dhe plastike në sektorin e hotelerisë, Administrata bashkiake e Donostia-San Sebastián, Spanjë, 2006 (në Spanjisht).
- Projekti "Plastika naša vsakdanja", Qeveria e Sllovenisë, Sllloveni, 2018 (në gjuhën Sllovene).
- Fushata në favor të ujit të rubinetit, Qeveria e Sllovenisë, Sllloveni, 2019 (në gjuhën Sllovene).

Shtojca IV

Terminologjia

Termat e përgjithshme

Prokurimi i Qëndrueshëm Publik (PQP)

Proces përmes të cilit organizatat publike plotësojnë nevojat e tyre për mallra, shërbime, punë dhe shërbime nënjë mënyrë që të arrijnë vlerën për para në bazë të ciklit jetësor. Kjo nënkupton krijimin e përfitimeve jo vetëm për organizatën, por edhe për shoqërinë dhe ekonominë, ndërsa zvogëlon ndjeshëm ndikimet negative në mjedis[20].

Prokurimi i Gjelbër Publik (PGjP)

Proces me të cilin autoritetet publike kërkojnë të prokurojnë mallra, shërbime dhe punime me ndikim të reduktuar mjedisor përgjatë gjithë ciklit të jetës së tyre, në krahasim me mallrat, shërbimet dhe punimet me të njëjtin funksion parësor që përndryshe do të prokuroheshin[21].

Ekonomia qarkulluese

Duke parë përtej modelit aktual industrial "nxirr, prodho dhe hidh", një ekonomi qarkulluese synon të ripërcaktojë rritjen, duke u përqëndruar në përfitime pozitive në mbarë shoqërinë. Kjo përfshin gradualisht zbërthimin e aktivitetit ekonomik nga konsumi i burimeve të fundme dhe hartimi i politikave për lënien e mbetjeve jashtë sistemit. Mbështetur nga një kalim në burimet e rinovueshme të energjisë, modeli qarkullues ndërton kapital ekonomik, natyror dhe social. Ajo bazohet në tre parime: hartimi i politikave për lënien e mbetjeve dhe ndotjes jashtë sistemit; mban produktet dhe materialet në përdorim, rigjeneroni sistemet natyrore[22].

Analiza e ciklit jetësor

Referuar gjithashtu si vlerësimi i ciklit jetësor, është një teknikë për të vlerësuar ndikimet mjedisore të shoqëruara me të gjitha fazat e jetës së një produkti nga nxjerrja e lëndës së parë përmes përpunimit, prodhimit, shpërndarjes, përdorimit, riparimit dhe mirëmbajtjes, dhe asgjësimit ose riciklimin. Aplikimet më të rëndësishme janë këto: (i) analiza e kontributit të fazave të ciklit jetësor në ngarkesën e përgjithshme mjedisore, zakonisht me qëllim për të prioritizuar përmirësimet në produkte ose procese; (ii) krahasimi midis produkteve për përdorim të brendshëm[23].

Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit

Qasja e politikës nën të cilën prodhuesit marrin përgjegjësi - financiare dhe / ose fizike - për trajtimin ose asgjësimin e produkteve pas konsumit. Caktimi i një përgjegjësie të tillë në parim mund të sigurojë stimuj për të parandaluar mbetjet në burim, promovimin e modelimit të produktit për mjedisin dhe mbështetjen e arritjes së qëllimeve të riciklimit publik dhe të menaxhimit të materialeve[24].

Përkufizime të përgjithshme në lidhje me plastikën

Plastik

Material i përbërë nga ndonjëra prej një game të gjerë të përbërjeve organike sintetike ose gjysmë sintetike që janë të lakueshme dhe kështu mund të formohen në objekte të ngurta. Plastikat janë tipikisht polimere organike me masë të lartë molekulare dhe shpesh përmbajnë substanca të tjera. Ato janë zakonisht sintetike, që rrjedhin më së shpeshti nga petrokimikët, megjithatë, një grup variantesh bëhen nga materiale të rinovueshme siç janë acidi poliklaktik nga misri ose celulozikët nga shtresa pambuku[25].

Plastika njëpërdorimëshe

Shpesh quhet plastikë e depozitueshme, zakonisht përdoren vetëm një herë para se të hidhen ose riciklohen. Këto përfshijnë, midis artikujve të tjerë, paketimin e ushqimit, qeset plastike, pipëzat, shishet, kontejnerët, kapakët, përzjerësit e kafes, gotat dhe serviset, për të cilat plastika përdoret gjerësisht për shkak të butësisë, kostos së ulët dhe veçorive praktike[26].

Mikroplastika

Copa të vogla plastike, më pak se 5 mm gjatësi, që ndodhen në mjedis si pasojë e ndotjes plastike. Mikroplastikat vijnë nga një larmi burimesh, duke përfshirë mbetjet e mëdha plastike që degradohen

21. Përkufizimi i adoptuar nga Programi 10 YFP SPP nga: Task Force e Prokurimit të Qëndrueshëm në Mbretërinë e Bashkuar (2006). Prokurimi i së Ardhmes. Departamenti i MB për Mjedisin, Ushqimin dhe Punët Rurale.

22. Komunikimi (2008) 400 nga Komisioni në Parlamentin Evropian, Këshillii, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve të 16 korrikut 2008 për prokurimin publik për një mjedis më të mirë.

23. Fondacioni Ellen MacArthur 2017, cfarë është një ekonomi qarkulluese? Një kornizë për një ekonomi që është restauruese dhe rigjeneruese nga dizajni, Fondacioni Ellen MacArthur, parë më 14 tetor 2019. https://www.ellenmacarthurfoundation.org/circular-economy/concept.

24. Muralikrishna I. & Manickam V. (2017). Vlerësimi i ciklit jetësor. Në menaxhimin e mjedisit (f. 57-75). Oxford: Butterëorth-Heinemann.

25. OECD (2001). Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit: Një manual/udhëzues për qeveritë. Paris: Botimi i OECD.

26. SCP / RAC 2019. Udhëzime për të larguar qeset plastike njëpërdorimëshe në Mesdhe. http://www.cprac.org/sites/default/files/otherfiles/11_guidelines_supb_en_0.pdf.

27. UNEP (2018). Plastikë njëpërdorimëshe: një udhërrëfyes për qëndrueshmëri. http://wedocs.unep.org/handle/20.500.11822/25496

në copa më të vogla. Për më tepër, mikrobetë, një lloj mikroplastike, janë copa shumë të vogla të plastikës së prodhuar polietileni që shtohen si eksfoliante të produkteve të shëndetit dhe bukurisë, siç janë disa pastrues dhe pasta dhëmbësh. Këto grimca të vogla kalojnë lehtësisht përmes sistemeve të filtrimit të ujit dhe përfundojnë në oqean. Mikroplastikat janë gjithashtu të pranishme në veshje sintetike[27].

Plastikë me bazë bio

Plastika me bazë bio rrjedh nga biomasa siç është materiali organik i mbetjeve ose të leshtat të rritura posaçërisht për këtë qëllim. Disa polimere të bëra nga burimet e biomasës, siç është misri, mund të jenë jo biodegraduese[28].

E aftë të biodegradohet[29]

Paketimi parësor ose i shitjeve

Paketimi i konceptuar në mënyrë që të përbëjë një njësi shitje për përdoruesin përfundimtar ose konsumatorin në pikën e blerjes.

Paketimi sekondar ose i grupuar

Paketimi i konceptuar në mënyrë që të përbëjë në pikën e blerjes një grupim të një numri të caktuar të njësive të shitjes nëse kjo e fundit është shitur si e tillë për përdoruesin përfundimtar ose konsumatorin ose nëse shërben vetëm si një mjet për të rimbushur rafte në pikën e shitjes; ai mund të hiqet nga produkti pa ndikuar në karakteristikat e tij.

Paketimi terciar ose i transportit

Paketimi i konceptuar në mënyrë që të lehtësojë mbajtjen dhe transportimin e një numri njësish shitjeje ose paketimi të grupuar për të parandaluar mbajtjen fizike dhe dëmtimin gjatë transportit. Paketimi i transportit nuk përfshin kontejnerë rrugorë, hekurudhor, anije dhe ajër.

Përkufizime të përgjithshme në lidhje me biodegradimin e polimereve vi[30]

Biodegradimi

Procesi biologjik i lëndës organike, i cili është shndërruar plotësisht ose pjesërisht në ujë, CO2/metan, energji dhe biomasa e re nga mikroorganizmat (bakteret dhe kërpudhat). Kushtet në të cilat polimeret "e biodegradueshëm" në të vërtetë do të biodegradojnë ndryshojnë shumë. Për shembull, një qese plastike njëpërdorimëshe e shënuar 'e biodegradueshme' mund të kërkojë kushtet që ndodhin zakonisht vetëm në një kompozitor industrial (p.sh. midis 50 ° C dhe 60 ° C) për tu zbërthyer plotësisht në përbërësit përbërës të tij të ujit, dioksidit të karbonit, metan, në një hark kohor të arsyeshëm ose praktik.

E biodegradueshme

E aftë të biodegradohet.

E kompostueshëm

I aftë të biodegridohet në temperatura të larta në tokë nën kushte të specifikuara dhe shkallë kohore, zakonisht të hasura vetëm në një facilitet për kompostim industrial (aplikohen standardet).

Oxo-degradueshëm

Polimere konvencionale, të tilla si polietileni, të cilat kanë shtuar një kompleks metalik të shtuar për të vepruar si një katalizator, ose pro-oksidues, për të rritur shkallën e oksidimit dhe copëzimit fillestar. Ato nganjëherë quhen si oksigjen-biodegraduese ose oxo-degradueshme. Degradimi fillestar mund të rezultojë në prodhimin e shumë fragmenteve të vogla (d.m.th. mikroplastikë), por në të vërtetë fati i tyre nuk dihet. Ashtu si me të gjitha format e degradimit dhe shkalla e fragmentimit dhe përdorimit nga mikroorganizmat do të varet nga mjedisi rrethues. Duket se nuk ka asnjë provë të botuar bindëse se plastika e degradueshme mund të mineralizohet plotësisht në mjedis, përveç në kushtet e kompostimit industrial.

EN 13432

Standardi Evropian i komposueshmërisë për paketimin e biodegradueshëm, i projektuar për trajtim në objektet e kompostimit industrial dhe trajtimit anaerob, duke kërkuar që të paktën 90% e lëndës organike të shndërrohet në CO2 brenda 6 muajsh, dhe që jo më shumë se 30% e mbetjeve mbetet në një site/rrjetë 2 mm pas 3 muajsh kompostimi. Standardi EN 14995 përshkruan të njëjtat kërkesa dhe teste, megjithatë ai vlen jo vetëm për paketimin, por plastikën në përgjithësi. E njëjta gjë vlen për ISO 18606 "Paketimi dhe Mjedisi - Riciklimi Organik" dhe ISO 17088 "Specifikimet për plastikën e kompostueshme".

28. NOAA 2018, Cfarë janë mikroplastikat ?, Shërbimi Kombëtar i Oqeanit, parë në 14 tetor 2019 https://oceanservice.noaa.gov/facts/microplastics.html

29. SCP / RAC 2019. Udhëzime për të larguar qeset plastike njëpërdorimëshe në Mesdhe. http://www.cprac.org/sites/default/files/otherfiles/11_guidelines_supb_en_0.pdf.

30. Bashkimi Europian. Direktiva 94/62 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 dhjetorit 1994 mbi paketimin dhe mbetjet e paketimit. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian L 365, 31 Dhjetor 1994, f. 10. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A31994L0062

UN environment
United Nations Environment Programme

Mediterranean Action Plan
Barcelona Convention

Regional Activity Centre
for Sustainable Consumption
and Production

Regional Activity Centre for Sustainable Consumption and Production (SCP/RAC)
UN Environment/Mediterranean Action Plan – Barcelona Convention for the protection of the Mediterranean Sea

Sant Pau Art Nouveau Site – Nostra Senyora de la Mercè Pavillion
Carrer de Sant Antoni Maria Claret, 167.
08025 Barcelona, Catalunya (Spain)
Tel. +34 93 553 87 90

www.scprac.org